


SIMONA ZAFIROVSKA TEUTA ALIMI SELMANI

# ARTI MUZIKOR

për vitin I

të gjimnazeve



**litera**  
group

**ARTI MUZIKOR**

**për vitin I**

**të gjimnazeve**

# ARTI MUZIKOR

Tekst mësimor për vitin I  
të gjimnazeve

E miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës  
me vendim nr. 26-934/1

## Autorë

Simona Zafirovska  
Mr. Teuta Alimi Selmani

## Botues

Litera Group

## Përkthyes

Mr. Teuta Alimi Selmani

## Redaktor

Samije Limani Musliu

## Redaktim profesional

Gonxhe Mehmedi

## Recensentë

Mr. Lile Anastasova  
Dr. Fatos Lumani

## Redaktim gjuhësor

Fexhide Zeqiri  
Gjilsime Jashari

## Dizajn grafik dhe teknik

Litera Group  
Rina Adili  
Muhamedali Jusufi

## Shtypshkronja

Polyesterday - Shkup

**Tirazhi:** 1546

**Vendi dhe viti i botimit:** Shkup, 2025

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска  
biblioteka „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.5.016:78(075.3)

ZAFIROVSKA, Simona

Arti muzikor : Tekst mësimor për vitin I të gjimnazeve / Simona  
Zafirovska, Teuta Alimi Selmani ; përkthyes Teuta Alimi Selmani. - Shkup  
: Litera Group, 2025. - 120 стр. : фотографии ; 21 см

Библиографија: стр. 117-118. - Содржи и: Речник

ISBN 978-608-4855-75-0

1. Alimi Selmani, Teuta [автор] [преведувач]

а) Музичка уметност -- Учебници за средни училишта

COBISS.MK-ID 66796293

# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>5</b>
<b>ARTI MUZIKOR NËPËR KOHË .....</b>	<b>7</b>
<b>RËNDËSIA E MUZIKËS PËR NJERIUN DHE PËR SHOQËRINË .....</b>	<b>9</b>
<b>MUZIKA NË BASHKËSITË PRIMITIVE DHE NË KOHËN E LASHTË.....</b>	<b>11</b>
Prejardhja e muzikës në bashkësitë primitive .....	11
Sinkretizmi në muzikë .....	11
<b>RËNDËSIA E MUZIKËS DHE MUZIKANTËVE NË CIVILIZIMET</b>	
<b>E LASHTA .....</b>	<b>13</b>
Muzika në civilizimet e lashta .....	13
(Babilonia, Egjipti dhe Kina).....	13
Muzika në Greqinë e Lashtë dhe në Romë .....	15
Shkallët muzikore në civilizimet e lashta .....	18
<b>MUZIKA NË MESJETË DHE NË RILINDJE .....</b>	<b>19</b>
Kultura muzikore në mesjetë – religjioze dhe laike (joreligjioze).....	19
Rilindja.....	23
Xhovani Perluixhi da Palestrina (1525–1594).....	25
Orlando di Laso (1532–1594).....	27
<b>MUZIKA NË BAROK – EPOKË E LËVIZJES, KONTRASTIT DHE SHPREHJES</b>	
<b>ARTISTIKE .....</b>	<b>29</b>
Instrumentet muzikore të barokut .....	31
Format muzikore të barokut.....	33
Paraqitja e operës .....	36
Georg Fridrih Hendel (1685–1759) .....	39
Johan Sebastian Bah (1685–1750).....	41
Antonio Vivaldi (1678–1741) .....	43
<b>DËGJIM I UDHËZUAR .....</b>	<b>45</b>
<b>TEORIA E MUZIKËS NËPËRMJET PRAKTIKËS .....</b>	<b>47</b>
<b>SHKALLËT DHE INTERVALLET .....</b>	<b>49</b>
Sistemi tingullor dhe oktavat .....	49
Emërtimi i tingujve në çelësin e violinës dhe basit.....	51
Tinguj të ngritur dhe të zbritur – shenjat e shartimit .....	52
(diezi, bemoli dhe bekuadri) .....	52
Shkalla muzikore dhe elementet e saj .....	54
C-dur .....	54
(Shkalla themelore).....	54
Shkallët mol .....	56



a-mol natyral .....	57
a-mol harmonik .....	58
a-mol melodik .....	58
G-dur .....	59
e-mol natyral .....	61
e-mol harmonik .....	61
e-mol melodik .....	62
F-dur .....	63
d-mol natyral .....	64
d-mol harmonik .....	64
d-mol melodik .....	65
Intervalet .....	66
<b>RITMI, METRI DHE TAKTI .....</b>	<b>69</b>
Piramida e vlerave të notave dhe pushimeve të tyre .....	69
<b>APLIKACIONE PËR SHKRIMIN E NOTAVE .....</b>	<b>78</b>
<b>INTERPRETIMI MUZIKOR DHE SHPREHJA KREATIVE .....</b>	<b>79</b>
<b>INTERPRETIMI VOKAL DHE LUAJTJA NË INSTRUMENTE .....</b>	<b>81</b>
Interpretimi vokal .....	81
Interpretim kolektiv vokal dhe instrumental .....	89
<b>SINKRETIZMI NË ART .....</b>	<b>92</b>
<b>TRASHËGIMIA KULTURORE MUZIKORE .....</b>	<b>93</b>
<b>KËNGA NË TRADITËN POPULLORE MAQEDONASE DHE NË TRADITËN E POPULLORE QË JETOJNË NË RMV .....</b>	<b>95</b>
Këndimi tradicional .....	96
<b>VALLËZIMET DHE VALLET POPULLORE NË TRADITËN POPULLORE .....</b>	<b>99</b>
Muzika folklorike – tradicionale dhe ajo e re autoriale .....	99
Vallëzimet dhe vallet popullore .....	105
Stilet dhe llojet e vallëzimeve dhe valleve popullore .....	106
<b>INSTRUMENTET NË TRADITËN POPULLORE .....</b>	<b>108</b>
Instrumentet popullore dhe ndarja e tyre .....	108
Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë muzikore popullore .....	111
<b>FJALOR .....</b>	<b>113</b>
<b>LITERATURA E SHFRYTËZUAR .....</b>	<b>117</b>

## HYRJJE

Muzika ka qenë gjithmonë pjesë e ekzistencës njerëzore – zëri i kohës, pasqyrim i shpirtit dhe urë lidhëse mes së kaluarës dhe së tashmes.

Që nga civilizimet e lashta, përmes mesjetës, barokut, klasicizmit dhe romantizmit, e deri te stilet muzikore bashkëkohore, ajo i ka shoqëruar njerëzit në të gjitha gëzimet, sfidat dhe ëndrrat e tyre.

Por, muzika nuk është vetëm art – ajo është edhe gjuhë, shkencë, kulturë dhe emocion.

Ky libër shkollor është krijuar me qëllim që t’u ndihmojë të rinjve ta njohin muzikën në tërë shkëlqimin e saj:

- ta kuptojnë përmes teorisë,
- ta përjetojnë përmes interpretimit,
- ta respektojnë përmes traditës dhe
- ta shprehin përmes krijimtarisë së tyre personale.

Të rinjtë sjellin freski, energji dhe perspektiva të reja. Kur ata njihen me trashëgiminë kulturore muzikore dhe mësojnë si ta lexojnë, ndjejnë dhe interpretojnë muzikën, ata bëhen jo vetëm interpretues, por edhe bartës të vazhdimësisë artistike.

Ky libër shkollor do të ofrojë:

- njohuri për teorinë dhe historinë e muzikës,
- udhëzime për interpretim muzikor dhe shprehje krijuese,
- njohje me muzikën tradicionale dhe bashkëkohore dhe
- nxitje për zhvillim personal përmes artit.

Le të jetë ky udhëtim përmes muzikës një frymëzim, një zbulim dhe një mundësi për rritje personale. Sepse çdo i ri që takohet me muzikën – takohet me vetveten.

# SI TA PËRDORËSH KËTË LIBËR SHKOLLOR

Ky libër shkollor përmban disa elemente strukturore që dallohen vizualisht nga njëri-tjetri. Ky udhëzues i shkurtër do të të shërbejë si mbështetje në procesin e të mësuarit dhe do të të ndihmojë t'i kuptosh dhe përdorësh pjesët e ndryshme të këtij teksti shkollor.

Në faqet hyrëse të secilës temë paraqiten përmbajtjet, që përputhen me programet dhe standardet mësimore, si dhe një përmbledhje e asaj që do të mësosh në secilin leksion.



Ky libër shkollor është pasuruar me materiale vizuale dhe paraqitje grafike. Kjo do t'ju ndihmojë të zotëroni në mënyrë më efektive përmbajtjen, duke nxitur njëkohësisht edhe imagjinatën tuaj.



Teksti kryesor thekson idetë kryesore dhe qartë tregon lidhjet mes koncepteve, duke mundësuar një shpjegim sistematik dhe të kuptueshëm të përmbajtjeve të reja. Termat dhe definicionet e rëndësishme janë paraqitur me shkronja të theksuara.



Teksti shkollor përmban edhe **tekste shtesë** që e zgjerojnë përmbajtjen bazë dhe e bëjnë më interesante për të mësuar. Këto pjesë janë të theksuara qartë me dizajn grafik të veçantë për t'i dalluar më lehtë.

## Mëso më shumë!

Fjala “muzikë” rrjedh nga fjala e vjetër greke “μουσική” (musike), që në kuptim të plotë do të thotë “arti i muzave”. Në mitologjinë greke kishte nëntë muza – perëndesha që ishin mbrojtëse të artit dhe shkencave të ndryshme (poezi, muzikë, tragjedi, komedi etj.). Grekët besonin se muzika ka fuqi të formësojë personalitetin dhe karakterin e njeriut.

*Mëso më shumë* është një rubrikë për të gjithë nxënësit që dëshirojnë të dinë më shumë dhe të kenë informacione shtesë lidhur me mësimin.

*Aktivitetet* është një pjesë që ju mundëson të praktikoni detyra të lidhura me mësimin. Këto aktivitete ndihmojnë në zhvillimin e të mësuarit interaktiv përmes detyrave kreative.

## Aktivitet:

### 1. Diskutim

Tema: Muzika dhe pushteti – si e kanë përdorur sundimtarët muzikën?

Pyetje për të nxitur diskutimin:

- A mendoni se muzika ka qenë një mjet për kontroll apo për frymëzim?
- Cila ka qenë lidhja mes muzikës dhe fesë?
- Kush ka pasur qasje në muzikë – vetëm elita apo edhe populli i thjeshtë?

# 1. ARTI MUZIKOR NËPËR KOHË

## PËRMBAJTJA:

- Rëndësia e muzikës për njeriun dhe shoqërinë
- Muzika në bashkësitë primitive dhe në kohën e lashtë
- Muzika në mesjetë dhe në rilindje
- Muzika në barok
- Dëgjim i udhëzuar

## Koncepte kyçe:

- muzika, mjetet shprehëse muzikore, shija muzikore, zhanret muzikore, kultura muzikore
- sinkretizmi, shenjat për shënimin e muzikës, radhitja tonale, tetrakordi, shkolla Pitagoriane, intervalet dhe proporcionet, tragjedia e lashtë greke
- muzika religjioze: korali gregorian, mesha, shumëzërëshi, organumi, notacioni, Guido nga Areco, solmizimi, këndimi lindor, Jan Kukuzeli; muzika laike: trubadurët; polifonia vokale, moteti, madrigali, balada, kanconeta, pavana dhe galiarda, Palestrina, Orlando di Laso; instrumentet muzikore
- polifonia instrumentale, motorika, sistemi dur-mol, harmonia, akordi, instrumente muzikore të barokut, format instrumentale: suita, koncerto grosso, koncerti, preludiumi, fuga; format vokalo-instrumentale: opera, aria, reçitativi, oratoriumi, kantata, pasioni, korali; Kamerata fiorentine, operat e para; Klaudio Monteverdi, Johan Sebastian Bah, Georg Fridrih Hendel, Antonio Vivaldi
- kompozitori, vepra, interpretuesi, ansambli interpretues, mjetet shprehëse.

## Do të mësosh:

- t'i dallosh epokat muzikore, t'i përshkruash veçoritë e tyre themelore dhe të përmendësh kompozitorë të shquar që u përkasin periudhave muzikore;
- t'i dallosh dhe të kategorizosh instrumentet muzikore dhe ansamblet në veprat që dëgjon;
- ta ndërlidhësh rolin e kompozitorëve, interpretuesve dhe dëgjuesve në procesin e krijimit, interpretimit dhe pranimit të artit muzikor gjatë historisë;
- të shpjegosh për mjetet shprehëse muzikore, polifoninë dhe sistemin dur-mol në veprat që dëgjon;
- t'i njohësh format muzikore sipas epokave muzikore dhe të shpjegosh për lidhshmërinë e tyre me karakterin e veprave të dëgjuara, duke përdorur terminologji përkatëse muzikore.



## RËNDËSIA E MUZIKËS PËR NJERIUN DHE PËR SHOQËRINË



Muzika është një gjuhë universale që e shoqëron historinë e njerëzimit që nga kohërat më të lashta e deri në ditët e sotme. Ajo është e pranishme në përditshmërinë e njerëzve – në festa, rituale, ceremoni fetare, protesta, por edhe në momente qetësie dhe reflektimi. Përmes muzikës, njeriu shpreh ndjenja, mendime, ide dhe formëson ndërgjegjen e tij shpirtërore dhe kulturore.

Muzika ka ndikim të fuqishëm mbi emocionet dhe gjendjen shpirtërore – mund të na gëzojë, të na ngushëllojë, të na nxisë për lëvizje ose të na qetësojë. Në të njëjtën kohë, ajo luan edhe një rol të rëndësishëm shoqëror, duke ndërtuar ndjenjën e përkatësisë përmes këndimit të përbashkët, vallëzimit apo dëgjimit të muzikës duke krijuar ndjenjën e bashkësisë dhe bashkëpunimit.

Muzika shpesh lidhet me artet e tjera, si letërsia, piktura, filmi apo teatri. Për shembull, muzika në film e forcon atmosferën dhe e udhëheq emocionin e shikuesit. Në teatër, muzika ndjek rrjedhën dramatike dhe e plotëson shprehjen skenike. Edhe në vallëzimin modern apo performancat skenike, muzika është një element i pandashëm që jep strukturë dhe ritëm.

Por, çfarë është në të vërtetë muzika? Muzika është tingull i organizuar që ndjek parime dhe mjete të caktuara shprehëse si ritmi, melodia, harmonia dhe dinamika. Ajo mund të jetë e thjeshtë ose komplekse, të interpretohet nga zëri i njeriut, nga një instrument apo një orkestër dhe mund të shërbejë për argëtim, relaksim, edukim, madje edhe si formë komunikimi.

Në muzikë ekzistojnë zhanre të ndryshme – klasike, popullore, xhaz, rok, pop, elektronike dhe të tjera. Çdo zhanër përdor mjete shprehëse muzikore karakteristike (si ritmi, melodia, harmonia, tempi, dinamika) për të përcjellë një estetikë ose një mesazh të caktuar. Për shembull, muzika klasike shpesh përdor strukturë dhe harmoni të ndërlikuar, ndërsa muzika pop është më e thjeshtë, por e drejtpërdrejtë dhe më e afërt me dëgjuesin.

Me zhvillimin e teknologjisë dhe mediave, muzika sot është e qasshme për të gjithë dhe përfaqëson një pjesë të kulturës globale. Ajo nuk është vetëm një formë argëtimi, por edhe një mjet për edukim, komunikim dhe shprehje artistike. Spektri i gjerë i zhanreve muzikore të ndryshme i jep mundësi secilit që, sipas shijes së vet, të zgjedhë se cili lloj i muzikës do të jetë prioriteti i tij.

### Mëso më shumë!

Truri i njeriut reagon ndaj muzikës në mënyrë të ngjashme si ndaj ushqimit ose dashurisë – dëgjimi i muzikës së preferuar çliron dopaminë, e cila nxit ndjenjën e lumturisë! Prandaj, ndonjëherë një këngë e vetme mund të na e bëjë ditën më të bukur për vetëm disa sekonda.

### Aktivitet:

#### 1. Diskutim – Si ndikon muzika tek ne?

Mendo në mënyrë kritike dhe shprehe mendimin tënd për rolin e muzikës në jetën personale dhe në shoqëri!

- Si do të ishte jeta jonë e përditshme pa muzikë?
- Çfarë muzike dëgjoni dhe pse?
- A ka ndonjë këngë që ju ka frymëzuar ose ju ka ndihmuar në një moment të vështirë?
- A mund ta ndryshojë muzika shoqërinë?
- A e ndajnë zhanret muzikore publikun apo e bashkojnë atë?

Organizimi: Diskutim i hapur në rreth, i udhëhequr nga mësimmshënësi. Nxënësit inkurajohen të dëgjojnë dhe të respektojnë mendimet e të tjerëve.





## MUZIKA NË BASHKËSITË PRIMITIVE DHE NË KOHËN E LASHTË

Muzika është një nga format më të vjetra të shprehjes dhe komunikimit në historinë e njerëzimit. Ajo ka qenë ngushtë e lidhur me natyrën, jetën e përditshme dhe besimet shpirtërore të njerëzve.

### Prejardhja e muzikës në bashkësitë primitive

Njeriu ka zbuluar muzikën përmes tingujve të natyrës – shushurimës së erës, zërit të shiut, tingëllimës së trokitjeve të gurëve dhe ritmit të zemrës. Besohet se shprehjet e para muzikore janë frymëzuar nga këta tinguj natyrorë dhe janë përdorur si mënyrë komunikimi dhe shprehjeje e emocioneve.

Është zbuluar se tinguj të ndryshëm mund të krijohen duke goditur gurë, dru apo ashte dhe në këtë mënyrë janë zhvilluar format dhe instrumentet më bazike ritmike muzikore, të cilat janë përdorur në rituale, valle dhe mbledhje shoqërore.

Disa antropologë mendojnë se thirrjet, britmat dhe këndimet primitive kanë qenë format e para të muzikës vokale. Ato janë përdorur për të koordinuar aktivitetet kolektive, si gjuetia, mbledhja e ushqimit dhe ndërtimi i strehimoreve.



*Flauti parahistorik*

### Sinkretizmi në muzikë



*Rituali i gjuetisë*

Në bashkësinë e hershme, muzika nuk ka ekzistuar si një formë e veçantë, por ka qenë pjesë e një shprehjeje më të gjerë **sinkretike** që i bashkonte muzikën, vallëzimin, dramën dhe mimikën. Njerëzit, përmes këndimit, vizatimit, lëvizjeve dhe goditjeve ritmike, shprehnin bashkësinë dhe besimet e tyre. Tek njerëzit primitivë, muzika ka qenë pjesë e pandashme e praktikave rituale, si magjia dhe besimet fetare. Ata besonin se tingujt ritmikë kishin fuqi të ndikonin mbi shpirtrat, forcat e natyrës dhe fatin në gjueti.

- **Ritualet e gjuetisë** – Njerëzit e parë kryenin vallëzime ritmike dhe këndonin këngë primitive para se të niseshin për gjueti, duke besuar se në këtë mënyrë do t'i zbutnin shpirtrat e natyrës.





## ARTI MUZIKOR NËPËR KOHË

- **Ceremonitë fetare** – Në disa shoqëri fisnore, muzika është përdorur për të thirrur shpirtrat e paraardhësve, perënditë, apo për të festuar dukuri natyrore si shiu, dielli dhe pjellshmëria.
- **Ritet e varrimit** – Muzika është përdorur edhe gjatë varrimeve, për të përcjellë shpirtin e të ndjerit në botën tjetër.

### Mëso më shumë!

Instrumentet e para muzikore datojnë që para 35 000 vjetësh! Fyelli më i vjetër i njohur është zbuluar në një shpellë në Gjermani dhe është punuar nga kocka e një mjellme ose e një mamuthi. Kjo do të thotë se që atëherë njerëzit jo vetëm që dëgjonin dhe krijonin muzikë, por kishin edhe dëshirë të eksperimentonin me materiale të ndryshme për të krijuar tinguj të bukur.

Muzika u ndihmonte të lidhen mes vete, të luten, të përballojnë frikën nga natyra, por edhe të argëtohen – pikërisht si sot!

### Aktivitete:

#### 1. Krijoni instrumentin tuaj muzikor “primitiv”!

Udhëzime:

- Ndahuni në dy grupe!
- Duke përdorur materiale natyrore ose të ricikluara (shishe, shkopinj, kanaqe, kokrra, gurë të vegjël, tela etj.), secili grup duhet të krijojë një instrument muzikor të thjeshtë që mund të prodhojë tingull.
- Secili grup ta paraqesë instrumentin e vet, t’i vendosë emër dhe të shpjegojë si përdoret dhe për çfarë “rituali” apo ngjarjeje do të përdoret (për gjueti, për shi, ritual për pjellshmëri etj.).
- Mund të realizohet edhe një imitacion i shkurtër i ritualit ku do të kombinohen tinguj, lëvizje dhe këndim.

#### 2. Diskutim: A ka muzika sot të njëjtin rol si në të kaluarën?

Pyetje hyrëse:

- Pse mendoni që muzika ka qenë kaq e rëndësishme për njerëzit në të kaluarën?
- A e ruan muzika edhe sot funksionin e saj shpirtëror, ritual dhe shoqëror?
- Në cilat momente të jetës suaj të përditshme e përdorni muzikën?
- Si ndikon muzika në emocionet dhe lidhjen mes njerëzve?



## RËNDËSIA E MUZIKËS DHE MUZIKANTËVE NË CIVILIZIMET E LASHTA

Kalimi nga bashkësia primitive shoqërore drejt rendit shoqëror skllavopronar solli shfaqjen e artit si një formë të pavarur të shprehjes shpirtërore, në të cilën muzika zë një vend të rëndësishëm. Me krijimin e shteteve të para, shoqëria skllavopronare formoi dy klasa të kundërta: klasën sunduese të skllavopronarëve dhe klasën e nënshtruar të skllavëve, ndërkohë që muzika ishte e pranishme në jetën e të dy grupeve.

Rëndësia e muzikës te qytetërimet e lashta ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Në shoqëritë më të hershme, ajo nuk ishte vetëm burim argëtimi, por kishte edhe funksion fetar, shoqëror dhe arsimor. Qytetërimet e lashta të Babilonisë, Asirisë, Sumerisë, Egjiptit, Kinës, Indisë, Greqisë së Lashtë dhe Romës e përdornin muzikën në rituale, kremtime, fushata ushtarake dhe në jetën e përditshme, ndërsa muzikantët gëzonin status të lartë dhe vlerësoheshin si bartës të vlerave shpirtërore dhe kulturore.

Secili prej këtyre qytetërimeve zhvilloi një instrumentarium të pasur, teori të muzikës dhe e lidhte muzikën me artet e tjera.



*Instrumente muzikore nga Babilonia*

### Muzika në civilizimet e lashta (Babilonia, Egjipti dhe Kina)

- **Babilonia** ka qenë një nga qytetet më të rëndësishme të Mesopotamisë së Lashtë dhe një qendër kulturore ku muzika ka pasur një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme dhe atë ceremoniale. Muzika është përdorur në ritualet fetare, festimet, ceremonitë mortore dhe në tregimet epike, siç është Epi i Gilgameshit. Instrumentet muzikore babilonase përfshinin daullet, flautat, boritë, sistrumet, lirat dhe harpat.

- **Egjiptianët e lashtë** nuk mund ta imagjinonin jetën e përditshme të klasës sunduese dhe të popullit pa praninë e muzikës. Në pallate dhe në tempuj, muzika i kushtohej lavdërimit të faraonëve dhe perëndive, ndërsa populli i thjeshtë krijonte dhe këndonte këngë që pasqyronin jetën e tyre të vështirë dhe modeste.

Sipas burimeve të ndryshme, në Egjipt organizoheshin manifestime të mëdha muzikore ku merrnin pjesë qindra muzikantë.


Reputacioni i muzikantëve ishte aq i lartë, sa që ata konsideroheshin madje edhe si të afërm të faraonëve. Në praktikën muzikore u zhvilluan gjini të ndryshme, sidomos në kultin ritual. Muzika përdorej në rite të ndryshme për nder të perëndive, në kremtime dhe ceremoni që ishin të paimagjinueshme pa muzikë dhe vallëzim, madje edhe në ceremonitë mortore ku vajtoheshin të vdekurit. Egjiptianët dallonin muzikimin individual dhe atë në grup, duke përdorur një numër të madh instrumentesh të ndryshme – instrumente ritmike, sistrum, instrumente frymore, ndërsa më e veçuar ishte harpa.



*Muzikantë nga Egjipti*



*Sistrumi*



*Harpa*

### Mëso më shumë!

Në Egjiptin e Lashtë, muzikantët shpesh ishin gra dhe gëzonin një status të lartë shoqëror. Madje kishte edhe gra që në tempuj shërbenin si priftëresha muzikante, dhe roli i tyre ishte të interpretonin muzikë të shenjtë gjatë ceremonive dhe riteve fetare.

Edhe pse në aspektin gjeografik dhe kulturor ishte e ndarë nga civilizimet e tjera të lashta të Lindjes, Kina e Lashtë arriti të zhvillojë një sistem original muzikor dhe të veçantë, i cili la gjurmë të thella në historinë e muzikës botërore. Muzika në Kinë nuk ishte vetëm një formë e shprehjes artistike, por edhe një pjesë e rëndësishme e edukimit, etikës morale dhe rendit shtetëror.



*Kambana kineze*



*Muzikantë kinezë*

- **Kinezët** herët e zhvilluan shkallën pentatonike (pesëtonëshe), e cila është baza e muzikës së tyre tradicionale që nga lashtësia e deri në ditët e sotme.

Sa u përket instrumenteve, muzika kineze përfshinte një numër të madh instrumentesh tradicionale (nga materiale të ndryshme), kryesisht instrumente me të goditur, por edhe instrumente me tela dhe frymorë.

Muzika në Kinën e Lashtë nuk kishte vetëm funksion argëtues, por përdorej edhe në ceremoni, rite fetare dhe veprimtari shtetërore. Harmonia midis tingujve, sipas filozofisë kineze, pasqyronte harmoninë midis njeriut dhe natyrës.



## Mëso më shumë!

Njëri nga mendimtarët më me ndikim të kulturës kineze, Konfuçi, i kushtonte rëndësi të madhe muzikës, duke e konsideruar atë si një mjet për ngritje shpirtërore dhe edukim moral. Sipas tij, “muzika e rregullt” krijon harmoni në shoqëri, ndërsa “muzika jo e rregullt” çon në degjenerim moral.

## Aktivitet:

### 1. Diskutim

Tema: Muzika dhe pushteti – si e kanë përdorur sundimtarët muzikën?

Pyetje për të nxitur diskutimin:

- A mendoni se muzika ka qenë një mjet për kontroll apo për frymëzim?
- Cila ka qenë lidhja mes muzikës dhe fesë?
- Kush ka pasur qasje në muzikë – vetëm elita apo edhe populli i thjeshtë?

## Muzika në Greqinë e Lashtë dhe në Romë


• **Grekët** e konsideronin muzikën si një nga artet më të rëndësishme, dhe studimi i saj ishte pjesë përbërëse e arsimit.

Zhvillimi i kulturës greke u mundësua dhe u nxit nga disa kushte shoqërore dhe ekonomike. Me krijimin e qytet-shteteve të pavarura (poliseve), një pjesë e popullsisë u përqendrua në art, shkencë dhe filozofi, duke bërë që Greqia të bëhej qendër e mendimit kulturor dhe intelektual, ndikimi i së cilës ndihet edhe sot.

Në Greqinë e Lashtë, artet si poezia, teatri, skulptura dhe arkitektura arritën nivele të jashtëzakonshme të shprehjes dhe estetikës. Muzika kishte një rol qendror në jetën e përditshme dhe atë shpirtërore, dhe mësimi i saj ishte pjesë integrale e arsimit të të rinjve.



Të gjitha ngjarjet e rëndësishme – nga garat sportive dhe Lojërat Olimpike që mbaheshin çdo katër vjet, deri te manifestimet teatrale dhe artistike – shoqëroheshin nga interpretimi muzikor. Muzika ishte ngushtë e lidhur me poezinë, duke krijuar një sintizë të pasur mes fjalëve dhe tingujve që pasqyronte shpirtin e kulturës antike.

Në Greqinë e Lashtë, instrumentet muzikore luanin një rol kyç jo vetëm në interpretimin e muzikës, por edhe në edukimin e të rinjve (një i ri i mirëarsimuar duhej patjetër të dinte të luante në një instrument). Instrumentet përdroheshin si në festa private, ashtu edhe në ngjarje publike, drama, gara sportive dhe rite fetare.




**Lira** – simbol i muzikës greke, e lidhur me kultin ndaj perëndisë Apolon – është një instrument me tela që mbante melodinë. Mësimi i lirës ishte pjesë e edukimit të të rinjve dhe përdorej në recitale poetike, ceremoni fetare dhe festa.

**Kitara** – version më i madh i lirës, përdorur nga muzikantë profesionistë.



**Aulosi** – një lloj flauti, me tingull të mprehtë dhe depërtues, që shpesh përdorej në shfaqjet teatrale dhe festivalet në nder të perëndisë Dionis.

**Fyelli i Panit** – i bërë nga disa gypa me gjatësi të ndryshme, e lidhur me perëndinë Pan.



Sa e madhe ka qenë rëndësia e muzikës në Greqinë e Lashtë na dëshmojnë filozofët e lashtë grekë dhe shkollat e tyre. Kështu, Pitagora (shekulli VI p.e.s.) ishte i pari që vendosi parimin se muzika është thellësisht e lidhur me matematikën dhe mund të shpjegohet përmes numrave dhe proporcioneve. Shkolla e Pitagorës vendosi themelet për estetikën muzikore, akustikën dhe etikën, dhe ndikimi i saj ndihet gjatë gjithë zhvillimit të mëtejshëm të mendimit muzikor perëndimor.

Pitagorianët besonin se muzika ka fuqi të pastrojë dhe të ndikojë në shpirtin e njeriut, që ndryshe quhet “katarzë muzikore”. Ata zhvilluan konceptin e “harmonisë së sferave”, sipas të cilit planetet lëvizin në orbita të përsosura duke krijuar një muzikë hyjnore, që nuk mund të dëgjohet nga veshi i njeriut.

### Mëso më shumë!

Fjala “muzikë” rrjedh nga fjala e vjetër greke “μουσική” (musike), që në kuptim të plotë do të thotë “arti i muzave”. Në mitologjinë greke kishte nëntë muza – perëndesha që ishin mbrojtëse të artit dhe shkencave të ndryshme (poezi, muzikë, tragjedi, komedi etj.) Grekët besonin se muzika ka fuqi të formësojë personalitetin dhe karakterin e njeriut.





**Tragedia** ka qenë një nga format më të rëndësishme të artit dramatik në Greqinë e Lashtë. Ajo u zhvillua nga ritualet fetare kushtuar perëndisë Dionis dhe gradualisht u shndërrua në një formë të lartë artistike, ku trajtoheshin tema mbi fatin, moralin, heroizmin dhe marrëdhënien midis njerëzve dhe perëndive.

Muzika kishte një rëndësi thelbësore në tragjedi. Roli i saj nuk ishte vetëm shoqërues, por kishte për qëllim të thellonte përjetimin emocional dhe të krijonte një atmosferë dramatike. Ajo interpretohej kryesisht nga kori, i cili njëkohësisht këndonte, recitonte dhe lëvizte në forma të koreografuara. Kori shërbente si zëri i komunitetit, komentues i ngjarjeve dhe ndërmjetës midis publikut dhe personazheve dramatike.

Kombinimi i tekstit, muzikës dhe lëvizjes krijonte një shprehje të fuqishme artistike, e cila hodhi themelet e teatrit evropian dhe operës.

• **Romakët** e morën kulturën muzikore nga Grekët, por e zhvilluan në format e tyre specifike. Në arenat dhe amfiteatrot romake, muzika përdorej për argëtim, prandaj në vend të tragjedisë greke, forma kryesore ishte **komedia** romake. Gjatë fushatave ushtarake, përdoreshin instrumente, kryesisht instrumente frymore prej metali (trumbeta, fanfara dhe të tjerë). Këta instrumente përdoreshin për komunikim dhe për të ngritur moralin e ushtarëve.



Muzikantë romakë

Instrumente të njohura në Perandorinë Romake ishin:

**Tibia** – versioni romak i aulosit, shpesh i përdorur në parada ushtarake.

**Kornus** – një lloj trumbete prej bronzi, e përdorur për sinjale ushtarake.

**Buçina** – një lloj tromboni i madh, që shërbente për shpalljen e urdhrave në ushtri.

**Organum** (*hydraulis*) – është një instrument i vjetër muzikor, paraardhës i organeve moderne, i cili prodhonte tingull me ajër të shtypur nga një pompë uji. Përdorej në amfiteatër për shfaqje dhe spektakle.



Instrumente nga Perandoria Romake



## Shkallët muzikore në civilizimet e lashta

Civilizimi	Llojet e shkallëve	Karakteristikat
<b>Babilonia</b>	Diatonike (supozohet)	Intervale të ngjashme me shkallën diatonike të sotme
<b>Egjipti</b>	Pentatonike, eventualisht diatonike	Shkallë bazuar në intonacionin natyror; muzika e lidhur me ritualet dhe adhurimin fetar
<b>Kina</b>	Pentatonike, diatonike, kromatike	Pentatonike, më vonë edhe sisteme 7-tonëshe dhe 12-tonëshe
<b>Greqia</b>	Diatonike, kromatike, enharmonike	Moduse të zhvilluara (dorike, frigjike, etj.); marrëdhënie të sakta matematikore (Pitagora)
<b>Roma</b>	Mbi bazën e moduseve greke	Sistemet greke të përvetësuara; nuk ka sistem origjinal të ri shkallësh

### Mëso më shumë!

Në Romën e Lashtë, muzikantët shpesh ishin pjesë e ushtrisë! Gjatë paradave dhe lëvizjeve ushtarake, muzika luante një rol të rëndësishëm – jo vetëm për efekt ceremonial, por edhe për komunikim! Me instrumente të veçanta frymore si kornum (korno) dhe tuba (tuba romana), ushtarët merrnin sinjale për lëvizje, sulm apo tërheqje. Këto sinjale ishin të kuptueshme edhe në fushëbeteja!

### Aktivitete:

#### 1. Hulumto dhe prezanto!

Ndahuni në dy grupe! Çdo grup zgjedh një civilizim (Greqia e Lashtë dhe Roma). Përcaktoni ngjashmëritë dhe dallimet midis kulturës muzikore të Greqisë së Lashtë dhe asaj Romake!

Në fund, bëni një prezantim të shkurtër (me poster ose *powerpoint*) para klasës!

#### 2. Diskutim

Tema: Pse muzika ka qenë kaq e rëndësishme në të gjitha civilizimet e lashta?

Pyetjet udhëzuese:

- Çfarë mendon, pse njerëzit kanë kënduar dhe luajtur në vegla muzikore mijëra vjet më parë?
- Cili ka qenë roli i muzikës në jetën e tyre?
- A ka muzika sot po të njëjtën rëndësi? Pse?



## MUZIKA NË MESJETË DHE NË RILINDJE



*Muzikantë të mesjetës*

### Kultura muzikore në mesjetë – religjioze dhe laike (joreligjioze)

Muzika në mesjetë (afërsisht nga shekulli V deri në shekullin XV) kishte një karakter thellësisht fetar dhe zhvillohej kryesisht brenda kornizës së kishës. Feja krishtere u bë fuqia dominuese në Evropë dhe muzika përdorej për të ngritur spiritualitetin dhe për të shprehur përkushtimin fetar.

Me rënien e Perandorisë Romake Perëndimore në shekullin V (viti 476) dhe ndarjen e Perandorisë Romake në atë *Perëndimore* dhe *Lindore*, qendra e zhvillimit kulturor dhe ekonomik u vendos në Perandorinë Lindore – Kostandinopojë (e cila arriti kulmin e saj në shekullin VI gjatë sundimit të perandorit Justinian). Perandoria Perëndimore ra nën pushtetin e popujve barbarë. Kjo zgjati derisa u konsolidua fuqia e romakëve, të cilët e pranuan

fenë e krishterë. Që nga ajo kohë, Kisha Katolike u bë institucioni më i fuqishëm dhe qendra e jetës kulturore dhe arsimore.

Muzika kryesisht kishte funksion fetar dhe zhvillohej në manastire dhe kisha.

Pas pranimit të krishterimit si fe zyrtare në Perandorinë Romake (në shekullin IV), muzika fillon të luajë rol kyç në jetën fetare. Kisha e njohu fuqinë e muzikës si mjet për ngritje shpirtërore dhe e integroi atë në shërbimet e saja fetare.

Format e para të **muzikës religjioze** ishin këngë të thjeshta, njëzërëshe me tekste biblike, të cilat këndoheshin nga kleriku ose besimtarët gjatë liturgjisë. Kjo muzikë kishte një karakter qetësues dhe lutës dhe ishte e destinuar për t'u afruar me hyjnoren.

Për të arritur një unifikim në praktikën liturgjike, kisha filloi të standardizonte disa melodi dhe forma të këndimit. Kjo çoi drejt paraqitjes graduale të një stili të unifikuar të këngës religjioze, i cili më vonë do të njihet si *korali gregorian*.



**Korali gregorian** përfaqëson një nga format më të rëndësishme të muzikës kishtare në mesjetë. Ai është këndim njëzënor (melodi njëzënore) me tekst në gjuhën latine dhe interpretohej vetëm me vokal (pa shoqërim instrumental) nga zëra të meshkujve. Përdorej në shërbimet fetare të Kishës Katolike Romake.

Korali gregorian përbën bazën e zhvillimit të mëtejshëm të muzikës perëndimore, veçanërisht në fushën e notacionit, polifonisë dhe arsimit muzikor.

Pas koralit gregorian njëzënor, gjatë shekujve IX–X fillon zhvillimi gradual i shumëzërëshit (polifonisë). Forma më e hershme e shumëzërit ishte **Organumi**, si një këndim paralel në kuarta dhe kuinta mbi bazën e melodisë gregoriane. Kjo formë u krijua në kuadër të shkollës së quajtur Notre Dame (sipas katedrales Notre Dame në Paris, ku edhe u zhvillua) nga ana e kompozitorëve të parë (joanonim) Leonin dhe Perotin dhe pësoi zhvillim nga dyzënor në trezënor dhe katërzënor. Kështu edhe u vendosën themelet e shumëzërëshit (polifonisë).




Koral gregorian



Guido nga Areco

Në mesjetë, muzika konsiderohej si një shkencë dhe një nga dukuritë më të rëndësishme ishte krijimi dhe zhvillimi i **notacionit**. Shenjat e para të shkrimit muzikor quheshin **neume** (nga fjala greke neume – shenjë). Ky sistem i shkrimit muzikor quhej notacion neumatik. Për t'i shënuar më lehtë tingujt, u krijua një sistem me katër vija dhe hapësira, e cila çoi deri te krijimi i notacionit të vjetër gotik me forma romboide (shek. XII - XV) dhe notacionit më të ri të quajtur notacioni roman, me forma katrore (shek. XIII - XV). Figura kyçe në zhvillimin e notacionit është **Guido nga Areco** (it. Guido d'Arezzo) – një nga teoricienët muzikorë më të hershëm të mesjetës dhe reformator i pedagogjisë muzikore. Ai përcaktoi vendosjen e neumeve në sistemin prej katër vijash dhe hapësirash dhe krijoi sistemin e solmizimit, i cili është themeli i notacionit modern me pesë vija dhe baza e solfezhit.

Ai i emërtoi gjashtë gradët e para të shkallës diatonike sipas rrokjeve të para të himnit kushtuar “Shën Gjonit”:



Himni i Shën Gjonit



Falë risive të tij, muzika mund të shkruhej me saktësi më të madhe.

Zhvillimi i muzikës gjatë mesjetës vazhdoi me krijimin e formave të reja liturgjike, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte **mesha**. Me kalimin e kohës, mesha u bë një nga veprat më të rëndësishme artistike polifonike, e ndërtuar nga disa pjesë dhe ishte formë e detyrueshme e shërbimit fetar katolik brenda kishës.

Ndërkohë, në lindje, në kuadër të perandorisë Lindore Bizantine, falë veprimtarisë së **Jan Kukuzelit (rreth shek. XIII–XIV)**, u zhvillua notacioni neumatik lindor dhe u hodhën themelet e shkrim-leximit muzikor.

Jan Kukuzeli ishte një nga reformatorët më të rëndësishëm të muzikës në Perandorinë Bizantine, i njohur me nofkën “Zëri engjëllor” për shkak të zërit të tij të mrekullueshëm dhe aftësive të jashtëzakonshme muzikore. Ai ishte teoricien, kompozitor dhe këngëtar i muzikës kishtare bizantine i shekullit XIV, i njohur për kontributet e tij në reformimin dhe sistematizimin e muzikës kishtare bizantine.

Në atë kohë, muzika bizantine shkruhej me notacion neumatik, i cili ishte i ndërlikuar dhe i vështirë për interpretim. Kukuzeli krijoi një sistem më të saktë dhe më të qasshëm për këngëtarët. Ai futi simbole dhe shenja të reja grafike që tregonin gjatësinë e tingujve dhe dinamikën, duke lehtësuar kështu interpretimin e muzikës kishtare. Këto reforma u bënë themel i zhvillimit të mëtejshëm të traditës muzikore bizantine dhe u përdorën për shekuj me radhë.



Jan Kukuzeli



Muzikantë të periudhës së mesjetës

**Muzika laike** (e kundërta e muzikës religjioze) është muzikë që nuk lidhet me temat fetare, ritualet ose funksionin kishtar. Ajo është muzikë e krijuar për argëtim, vallëzim, shprehje poetike ose shoqërore.

Muzikën laike (joreligjioze) e interpretonin **trubadurët, truverët** dhe **minesingerët** – poetë dhe muzikantë që udhëtonin nëpër oborre mbretërore dhe qytete, këndonin për dashurinë, trimërinë, natyrën apo jetën e përditshme. Këto këngë shpesh shoqëroheshin me instrumente si lira, fidela apo flauta. Karakteristikat e muzikës laike në mesjetë dallohen nga ajo religjioze në atë se tekstet janë në gjuhën popullore dhe jo në latinisht, temat janë dashuria, satira, heroizmi, natyra dhe përditshmëria.

Disa nga format më të njohura të muzikës laike në këtë periudhë janë:

- **Moteti** – edhe pse fillimisht kishte përmbajtje religjioze, gjatë shekujve XIV dhe XV filloi të shfaqet edhe në formë laike (joreligjioze), veçanërisht në Francë.
- **Madrigali** – formë vokale polifonike laike, shumë e popullarizuar në Itali në shekullin XVI. Temat më së shpeshti ishin të dashurisë ose të lidhura me natyrën.



- **Balada** – formë strofike me karakter rrëfimtar.
- **Kanconeta** – këngë laike më e lehtë dhe më e thjeshtë, e ngjashme me madrigalin.
- **Pavana dhe galiarda** – janë forma vallëzimi. Ato interpretoheshin në oborret mbretërore. Karakteristikë është se pavana ishte një vallëzim i ngadaltë dhe solemn, ndërsa galiarda ishte më e shpejtë dhe më kërcyese.

### Mëso më shumë!

Në mesjetë, muzika përcillej kryesisht në mënyrë gojore, pasi shumica e njerëzve nuk dinin të lexonin notacionin muzikor. Vetëm murgjit dhe njerëzit e arsimuar në manastire kishin qasje në dorëshkrimet muzikore. Ata i kopjonin me dorë, me shumë kujdes, i zbukuronin me iniciale të dekoruara dhe miniatura. Prandaj, dorëshkrimet e asaj periudhe nuk janë vetëm dokumente muzikore, por edhe vepra të vërteta arti.

### Aktivitet:

#### 1. Muzika religjioze dhe laike – dy fytyra të muzikës në mesjetë

Rrjedha e aktivitetit:

- Ndahuni në dy grupe!

Grupi **A**: përfaqëson dhe hulumton vlerat dhe rëndësinë e muzikës religjioze (koralit gregorian, liturgjia, Jan Kukuzeli etj.)


Grupi **B**: përfaqëson dhe hulumton vlerat dhe rëndësinë e muzikës laike (trubadurët, madrigalet, baladat, format vallëzuese etj.)

Në fund, nxënësit bëjnë një prezantim të shkurtër (me poster ose *powerpoint*) para klasës.





## Rilindja



“Lindja e Venerës” – nga S. Botiçelli

Rilindja (nga frëngjishtja *renaissance*, që do të thotë “rilindje”) është një lëvizje kulturore dhe artistike që fillon në Itali në shekullin XIV dhe përhapet nëpër Evropë deri në fillimin e shekullit XVII. Kjo epokë karakterizohet me rikthimin të idealet e antikitetit, zhvillimin e individualitetit të njeriut, dashurinë për natyrën dhe interesimin për shkencën, filozofinë dhe artin. Në të gjitha fushat e artit, përfshirë edhe muzikën, shfaqen stile, teknika dhe ide të reja që shënojnë rrugën drejt botës moderne.

Piktorët e Rilindjes zbulojnë vizatimin me perspektivë, saktësinë anatomike dhe shprehjen e emocioneve njerëzore. Ata synojnë realizmin dhe harmoninë. Është periudha e veprimtarisë së kolosëve si Leonardo da Vinçi (*Darka e Fundit, Mona Lisa*), Mikelanxhelo Buonaroti (*Kapela Sistine*), Rafaelo Sancio (*Shkolla e Athinës*). Në arkitekturë, rikthehen elementet e antikitetit – kupolat, shtyllat, simetria dhe harmonia gjeometrike. Letërsia e kësaj kohe sjell disa nga veprat më të bukura të mbushura me tema mbi moralin, dashurinë, shoqërinë dhe njeriun përmes pendës së Dante Aligierit (*Komedia Hyjnore*), Xhovani Bokaços (*Dekameroni*), Fransoa Rable, Uilliam Shekspirit dhe Migel de Servantesit.

Në muzikë, rilindja sjell përparime të mëdha në teknikë, harmoni dhe formë. Kompozitorët synojnë ekuilibrin, qartësinë dhe shprehjen. Edhe në këtë periudhë muzika ndahet në dy kategori kryesore: muzikë religjioze dhe muzikë laike (joreligjioze). Zhvillohen më tej format tashmë të krijuara si **mesha, moteti, madrigali, shansona**, të cilat bartin karakteristikat kryesore të muzikës së kësaj kohe si që është **polofonia** – muzikë shumëzërëshe, ku secili zë ka rëndësi të barabartë dhe është i pavarur dhe **imitacioni** – motivet përsëriten në zëra të ndryshëm duke krijuar një tërësi harmonike. **Instrumentet** gjithashtu përjetojnë një zhvillim të madh dhe përveç rolit të shoqërimit, fillojnë të përdoren edhe si mjete të pavarura për interpretim. Me zbulimin e shtypshkronjës së Gutenbergut në shek. XV (dhe për herë të parë më 1501 në Venedik u hap një shtypshkronjë muzikore), notat muzikore bëhen më të qasshme. Në këtë periudhë fillon të zhvillohet më tej muzika instrumentale, u paraqitën shënimet e para muzikore të shkruara për instrumente dhe u formuan ansamblet instrumentale.

Instrumentet më të njohura kanë qenë **liuti** – instrument me tela, i ngjashëm me kitarën, i përdorur si për solo ashtu edhe për ansamble, **viola da gamba** – paraardhëse e violonçelit, **klaviçembaloja** – paraardhës i pianos, i përdorur për argëtim në oborret mbretërore, **flauti** – instrument frymor prej druri, shumë i popullarizuar në këtë periudhë, **tamburi** – daulle e vogël dore me zile.

Muzikantët shpesh luanin në “konsorte” – grupe instrumentesh të njëjta ose të ngjashme (p.sh., ansambël me flautë të madhësive të ndryshme). Muzika për vallëzim (pavana, galiarda, kuranta etj.) ishte veçanërisht e njohur dhe interpretohej shpesh me ansamble të përziera.



*Instrumente të rilindjes*

### Mëso më shumë!

Në rilindje, muzikantët për herë të parë bëhen të famshëm si piktorët dhe skulptorët, e disa madje punësohen në oborret e fisnikëve si “kompozitorë të pallatit” – diçka që më parë ishte e rezervuar vetëm për piktorët dhe poetët.

### Aktivitet:

#### 1. Muzika e rilindjes – hapi i parë drejt harmonisë bashkëkohore

Pyetje për diskutim:

- A mendoni se rilindja e “çliroi” muzikantin si krijues?
- Cilat instrumente muzikore janë përdorur më së shumti në kohën e rilindjes?
- Me çfarë ndryshon muzika e rilindjes nga muzika e sotme?





## Xhovani Perluixhi da Palestrina (1525–1594)



Xh. P. da Palestrina

Xhovani Perluixhi da Palestrina (it. *Giovanni Pierluigi da Palestrina*) ishte një nga kompozitorët më të rëndësishëm të muzikës religjioze në periudhën e rilindjes. Ai jetoi dhe krijoi në shekullin XVI, një periudhë kur muzika përjetonte ndryshime dhe zhvillime të mëdha. Lindi në Itali, në qytetin Palestrina (nga i cili e ka marrë emrin), dhe veproi kryesisht në Romë, ku kompozoi muzikë kishtare.

Palestrina ishte përfaqësues i shkollës polifonike italiane, e njohur për muzikën e saj shumëzërëshe të rregullt dhe të qartë. Muzika e tij karakterizohet nga qetësia, balanca dhe harmonia e pastër, që i përshtateshin në mënyrë të përkryer nevojave të kishës në atë kohë. Ai e përdori mjeshtërisht polifoninë dhe përfaqëson shembullin e muzikës kishtare „të përsosur“, e cila e respekton tekstin dhe solemnitetin e liturgjisë. Veprat më të njohura të Palestrinës janë:

„**Mesha e papës Marçeli**” (*Missa Papae Marcelli*) – kjo është vepra e tij më e njohur. Thuhet se kjo meshë e bindi Vatikanin të lejonte përdorimin e polifonisë në kishë, pasi fjalët ishin të qarta dhe të kuptueshme.

Shumë **motete** – këto janë krijime religjioze. Shembuj: „*Sicut cervus*“, „*O admirabile commercium*“.

Mesha të tjera – ka shkruar mbi 100 mesha, secila me një bukuri dhe shprehje të veçantë.



Kyrie nga Mesha e Papës Marçeli



## Mëso më shumë!

Palestrina ishte aq emër me ndikim, sa që sot “stili palestrinian” përdoret si një term për polifoninë e qartë dhe të bukur kishtare.

## Aktivitete:

### 1. Dëgjojmë “Kyrie” nga Mesha e papës Marçeli –Xh.P. da Palestrina



Rrjedha e aktivitetit:

Dëgjeni me vëmendje, në heshtje. Vëreni se si zërat gërshetohen dhe i përgjigjen njëri-tjetrit!

Pyetje për diskutim:

- Si u ndjetë gjatë dëgjimit të muzikës?
- A arritët të dalloni disa zëra që këndojnë njëkohësisht?
- A tingëllon ndryshe nga muzika që dëgjoni çdo ditë? Në çfarë mënyre?
- A ju duket muzika e qetë, solemne apo ndryshe?

### 2. Mendo dhe përgjigju:

- Cilat janë veçoritë që e karakterizojnë muzikën e Palestrinës?
- Cilat janë veprat më të njohura të Palestrinës?
- Pse është e rëndësishme vepra “Mesha e papës Marçelli” në historinë e muzikës kishtare?



## Orlando di Laso (1532–1594)



O. di Laso

Orlando di Laso (*it. Orlando di Lasso*) ishte një nga kompozitorët më të njohur të rilindjes. Ka lindur rreth vitit 1532 në Mons (në Belgjikën e sotme) dhe ka vdekur në vitin 1594 në Mynih, Gjermani. Meqenëse ishte shumë i talentuar, që në fëmijëri udhëtonte dhe performonte nëpër Itali dhe vende të tjera.

Di Laso e kaloi tërë jetën duke punuar si muzikant dhe kompozitor në oborre mbretërore dhe në kisha, ndërsa për një kohë të gjatë ka qenë drejtor i muzikës në Mynih, ku krijoi pjesën më të madhe të veprave të tij.

Ai është një nga përfaqësuesit kryesorë të shkollës polifonike flamande. Muzika e tij është plot ekspresivitet, polifoni dhe pasuri emocionale. Orlando di Laso ka shkruar më shumë se 2000 kompozime të zhanreve të ndryshme – muzikë religjioze dhe laike, në gjuhë të ndryshme. Në fushën e muzikës religjioze ka kompozuar mesha, motete, psalme dhe pasione, ndërsa në muzikën

laike madrigale, kanconeta dhe shansone.

Disa vepra të njohura të Lasos:

“**Eho**” (*Eccho*) (*Jehona*) – këngë laike gazmore (madrigal), në të cilën përdoret efekti i jehonës për lojë muzikore dhe dialog zbatimës mes zërave.

“**Matona, e dashura ime**” (*Matona mia cara*) – këngë laike, shumë gazmore dhe e popullarizuar.

“**I trishtuar është shpirti im**” (*Tristis est anima mea*) – motet religjioz, plot me emocione dhe karakter serioz.

“**Eho**” është një kompozim polifonik i muzikës laike (joreligjioze), i shkruar në stilin e një kënge humoristike të llojit të madrigalit. Kjo është një nga veprat më të njohura të tij për shkak të karakterit lozonjar dhe humoristik. Është shkruar për dy kore – njëri bën pyetje ose thërret fjalë, ndërsa tjetri „përgjigjet” me jehonë, duke përsëritur pjesën e fundit të tekstit.

Kjo vepër është shembull i shkëlqyeshëm i kreativitetit në muzikën e Rilindjes, ku muzikantët jo vetëm që eksplorojnë thellësinë shpirtërore, por edhe argëtohen përmes lojërave dhe dialogjeve tingullorë. Është shkruar me ritëm të gjallë, teksturë të qartë dhe tekst humoristik dhe shpesh interpretohet edhe sot në kontekste edukative dhe koncertale.

Orlandus de Lasso. I. Cantus.

llige, ij dilige, dilige fo-  
litu- dinem, fo- litudinem, & fi-  
lentium, & inuenies, & inuenies ij quietem ma-  
gnam & conscientiam bonam, ij & conscientiam bonam, ij  
bo- nam.

Partiturë nga O. di Laso



“**Matona, e dashura ime**” është një nga veprat më të njohura laike të Orlando di Lasos. Ky madrigal është shkruar në gjuhën italiane dhe ka karakter zbavitës, pothuajse satirik. Në tekst, një ushtar i ashpër, i cili nuk flet mirë italisht, i shpreh dashuri një vajze në një mënyrë simpatike, por të “pafuqishme“. Kjo këngë është plot energji, ritmikiisht dinamike dhe melodikiisht tërheqëse, gjë që e bën të dashur në repertorin e ansambleve vokale.

Me këtë vepër, Orlando di Laso tregon jo vetëm mjeshtërinë e tij në polifoni, por edhe ndjenjën për humor dhe të shprehurit muzikor.

### Mëso më shumë!

Di Laso fliste disa gjuhë dhe kompozoi muzikë në latinisht, italisht, gjermanisht dhe frëngjisht. Muzika e tij ishte shumë e vlerësuar dhe interpretohej në të gjithë Evropën. Ai u shpall me titull nderi nga Papa Gregori XIII.

**Matona, l'ohelg matben.**  
(MATONA, MIA CARA.) \*  
MADRIGAL FOR FOUR VOICES.

Words imitated and adapted from the original Italian  
by W. A. BASSSETT. Composed by ORLANDO LASUS  
(1500-1554).

London: NOVELLO, EWER AND CO., 1, Bouverie Street (W.), and 40 & 41, Queen Street (E.C.)

*Moderately lively.*

SOPRANO:  
Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to . . . the song,  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa.

ALTO:  
Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to the song,  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa.

TENOR:  
Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to the song,  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa.

BASS:  
Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to the song,  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa.

ACCORDE (or lily):

Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to . . . the song I  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa Can -

Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to the song I  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa Can -

Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to . . . the song I  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa Can -

Ma - to - na, love - ly maid - en, O lis - ten to the song I  
Ma - to - na, mi - a ca - ra, Mi - ful - le - re - ca - sa Can -

Pjesë nga partitura  
“Matona, e dashura ime”

### Aktivite:

#### 1. Loja me kompozimin “Eho” (Jehona)

Hapat e aktivitetit:

- E dëgjojmë kompozimin “Eho” nga Orlando di Laso.



- Ndahuni në dy grupe!

- Një grup thërret fraza të shkurtra, ndërsa grupi tjetër menjëherë pas tyre i përsërit duke krijuar efektin e ehos.

- Përsëriteni disa herë me fjalë të ndryshme – ose përdorni frazat nga vetë vepra.

Bisedë e shkurtër: Si është ndjenja kur imitohet në formë ehoje dhe cili është efekti?

#### 2. Ritmi dhe karakteri në kompozimin “Matona, e dashura ime”

Hapat e aktivitetit:



- E dëgjojmë pjesën muzikore “Matona, e dashura ime” nga Orlando di Laso.

- A është muzikë serioze apo e gëzuar?

- Me çfarë ritmi dhe melodie karakterizohet ky kompozim?

Diskutim:

- A i vërejte elementet e parodisë?


#### 3. Mendo dhe përgjigju

- Çfarë e bën pjesën “Eho” (*Eccho*) kaq të veçantë dhe të njohur?

- Si paraqitet humorit dhe karakteri zbavitës në këngën “Matona, e dashura ime” (*Matona mia cara*)?



## MUZIKA NË BAROK – EPOKË E LËVIZJES, KONTRASTIT DHE SHPREHJES ARTISTIKE



“Alegoria e muzikës” nga Lorenzo Lipi

Në muzikë, periudha e barokut shfaqet në fillim të shekullit XVII dhe zgjat deri në mes të shekullit XVIII. Baroku fillimisht paraqitet në Itali, e më pas përhapet në tërë Evropën, duke përfaqësuar një epokë të transformimeve të mëdha artistike. Në këtë periudhë, në pikturë, arkitekturë dhe muzikë krijohen kryevepra artistike, të cilat janë arritje kulmore në historinë e kulturës perëndimore-evropiane.

Termi “barok” rrjedh nga fjala portugeze *barroco* ose nga ajo spanjolle *barrueco* që do të thotë “perle e çrregullt” dhe fillimisht përdorej me një konotacion negativ – për të shënuar diçka të ekzagjeruar dhe të ndërlikuar. Më vonë, fjala fillon të lidhet me artin i cili është i pasur, ekspresiv dhe dramatik.

Muzika baroke karakterizohet nga kontraste të forta (piano/forte, solo/kor), emocionalitet të thellë, ritëm të gjallë dhe linja melodike të zbukuruara. Gjatë kësaj

periudhe shfaqen forma të reja muzikore.

Në epokën e barokut, polifonia instrumentale zhvillohet shumë dhe bëhet mënyra kryesore e shprehjes muzikore.

Karakteristikë është **motorika baroke** – lëvizje ritmike e vazhdueshme që krijon energji dhe dinamikë. Vendoset **sistemi dur/mol**, i cili zëvendëson moduset e vjetra kishtare.

Harmonia e barokut karakterizohet nga tonaliteti i qartë, i përcaktuar nga funksionet themelore të akordeve (tonika, subdominanta, dominanta), ku akordi (bashkëtingëllima e më së paku tre toneve me lartësi të ndryshme) bëhet njësia themelore e ndërtimit muzikor. Përdorimi i **gjeneralbasit** ose basit të vazhdueshëm (basso continuo) bëhet baza e teksturës muzikore.

Muzika baroke zgjat rreth viteve 1580 deri 1730 (sipas disa burimeve deri në 1750).

Ajo zhvillohet në tri periudha – baroku i hershëm, i mesëm dhe i vonshëm.



## Mëso më shumë!

### **Baroku i hershëm (1580–1630)**

Në këtë fazë ndjehet rezistenca ndaj polifonisë vokale të rilindjes. Muzika bëhet më ekspresive, teksti merr një rol më të rëndësishëm dhe monodia (një vijë melodike me mbështetje harmonike) zëvendëson stilin e ndërlikuar polifonik. Përdoret gjeneralbasi (*basso continuo*) për të mbështetur meloditë. Në të njëjtën kohë, shfaqet opera, që paraqet shprehjen dramatike përmes muzikës dhe homofonia bëhet gjithnjë e më e zakonshme.

### **Baroku i mesëm (1630–1680)**

Në këtë periudhë shfaqet stili i quajtur belkanto – këndim i bukur, veçanërisht në operë, kantatë dhe oratorium. Lihen mënjandë moduset e vjetra dhe vërtetohet sistemi dur dhe mol. Zhvillohen forma të reja instrumentale, ku muzika instrumentale luan një rol kryesor dhe merr të njëjtën rëndësi si ajo vokale.

### **Baroku i vonshëm (1680–1730)**

Baroku i vonshëm përfaqëson kulmin e zhvillimit të stilit. Harmonia bëhet plotësisht tonale, ndërsa polifonia dhe kontrapunkti rikthehen me forcë dhe shprehje të reja. Format muzikore bëhen më të mëdha dhe më mbresëlënëse. Karakteristike është pulsimi ritmik – lëvizja e vazhdueshme, e njohur si motorika baroke. Muzika baroke është dramatike dhe kontrastuese – qetë/fortë (piano/forte), dritë/errësirë, individ kundrejt grupit. Muzika instrumentale merr më shumë rëndësi se ajo vokale.

- *Akordi* është bashkëtingëllima e më së paku tre toneve me lartësi të ndryshme.
- *Harmonia* është degë e shkencës muzikore që merret me studimin e akordeve dhe ndërlidhjen e tyre.
- *Gjeneralbasi* (*basso continuo*) është një mënyrë kompozimi dhe interpretimi në muzikën e barokut, ku linja e basit shërben si themel akordik i kompozicionit.
- *Tekstura* është karakteristika e përgjithshme e tingëllimës së një kompozimi muzikor.





## Instrumentet muzikore të barokut



Në epokën e barokut veçanërisht zhvillohet muzika instrumentale (ndryshe nga periudha e rilindjes) dhe ajo bëhet shumë e rëndësishme për krijimin e formave të reja muzikore, si vokalo-instrumentale ashtu edhe instrumentale. Përsoset edhe instrumentariumi (shprehje që përdoret në muzikë për të treguar përbërjen e instrumenteve muzikore që përdoren në një vepër, ansambël ose orkestër).

Në muzikën e barokut instrumentet më të përdorura janë:

- **Instrumentet harkore:** violina, viola, violonçeli, viola da gamba
- **Instrumente frymore:** flauti, blok-flauti, oboa, fagoti, trompa
- **Instrumente me tastierë:** çembalo dhe organo
- **Instrumente me të goditur:** timpanet

Instrumentet kryesore në periudhën e barokut ishin ato me tela dhe instrumentet me tastierë.



## Mëso më shumë!

Dallimi midis violonçelit dhe viola da gambës qëndron në faktin se violonçeli ka 4 tela, ndërsa viola da gamba ka 6 ose 7 tela. Tingulli i viola da gambës është më i butë, ndërsa mënyra e të luajturit dallon nga ajo e violonçelit.

## Aktivitete:

### 1. Pyetje dhe diskutim:

- Kur fillon epoka e barokut në muzikë dhe cilat janë karakteristikat kryesore të saj?

### 2. Grupi im instrumental

Hulumto dhe prezanto një grup instrumentesh të barokut.

Udhëzime:

- Ndahuni në tre grupe:

Grupi 1: Instrumentet harkore

Grupi 2: Instrumentet frymore

Grupi 3: Instrumentet me tastierë

Çdo grup duhet:

- Të emërtojë instrumentet që i përkasin grupit të tyre.
- Të zgjedhë një instrument dhe të shkruajë 2–3 fakte interesante për të.
- Të përgjigjet në pyetjen: Pse këto instrumente ishin të rëndësishme në epokën e barokut?
- Në fund, çdo grup prezanton punën e vet para të tjerëve.



## Format muzikore të barokut

Në periudhën e barokut, me zhvillimin e instrumentariumit, krijohen forma të reja muzikore instrumentale dhe vokalo-instrumentale, të panjohura më parë.

Suita, koncerto grosso, koncerti, preludiumi dhe fuga janë **forma muzikore instrumentale**, përmes të cilave realizohet muzika instrumentale.

**Suita** është një formë ciklike instrumentale e përbërë nga disa pjesë vallëzimi (alemanda, kuranta, sarabanda, zhiga, etj.) me karakter dhe prejardhje të ndryshme.

**Koncerto grosso** është një formë instrumentale në të cilën ka dialog mes një grupi të vogël solistësh (concertino) dhe të gjithë orkestrës (tutti ose concerto grosso). Është i pasur me kontraste.

**Koncerti** është një formë instrumentale për një instrument solistik (ose më shumë) dhe orkestër, ku ndërthuren pjesët ndërmjet solistëve dhe orkestrës, duke theksuar virtuozezin instrumentale.

**Preludiumi** është një vepër e shkurtër hyrëse, shpesh me karakter improvizues. Përdoret për të përgatitur dëgjuesin për kompozimin që pason (p.sh. fugën).

**Fuga** është një kompozim polifonik me shumë zëra, ku një temë zhvillohet dhe përsëritet në zëra të ndryshëm. Ka një strukturë të ndërlikuar dhe përfaqëson kulmin e polifonisë së barokut.



Partitura baroke

Në epokën e barokut, muzika vokalo-instrumentale zë një vend të rëndësishëm, duke kombinuar këndimin me shoqërimin instrumental. Gjatë kësaj periudhe zhvillohen disa forma të rëndësishme që shërbenin për të shprehur ide fetare, dramatike apo artistike. **Format** më të njohura **vokalo-instrumentale** të barokut janë **opera, oratoriumi, kantata, pasioni dhe korali**.

**Opera** është vepër vokalo-instrumentale-skenike ku veprimi dramatik realizohet përmes këndimit, muzikës dhe aktrimit. Ajo interpretohet në skenë me solistë, kor, orkestër, kostumografi dhe skenografi. Në vend që të flasin, personazhet në operë **këndojnë**.

Në operë, muzika është e ndarë në pjesë të ndryshme. **Aria** është pjesë e operës, e shkruar për një zë me shoqërim orkestral, e cila karakterizohet nga bukuria melodike, ekspresiviteti dhe virtuozeziteti. **Reçitativi** është pjesë ku këndimi i ngjan më shumë të folurit – shërben për të treguar ngjarjen dhe për të lidhur skenat. **Libretoja** është teksti i operës.

**Oratoriumi** është një formë vokalo-instrumentale dhe shkruhet për solistë, kor dhe orkestër. Është krijuar nën ndikimin e operës, por pa veprim skenik. Oratoriumi mund të jetë në gjuhën latine ose në gjuhën popullore. Të dy llojet kanë karakter religjioz.

**Kantata** është një formë vokalo-instrumentale me disa pjesë (kohë), e shkruar për solistë, kor dhe orkestër. Në periudhën e barokut shkruheshin kryesisht kantata religjioze dhe më pak kantata laike (joreligjioze), kurse kulmin e saj kjo formë muzikore e arriti me kompozitorin e madh Johan Sebastian Bah.

**Pasioni** është një vepër muzikore-dramatike që rrëfen vuajtjen dhe vdekjen e Jezu Krishtit, zakonisht e bazuar në tekstet ungjillore. Në këtë vepër muzikore marrin pjesë solistë, kor dhe orkestër dhe interpretohet në kishë, veçanërisht gjatë të Premtes së madhe.

**Korali** në barok është një vepër vokale fetare e shkurtër që këndohet nga kori ose nga të gjithë të pranishmit në kishë. Ai ka një melodi dhe tekst të thjeshtë dhe përdoret kryesisht në kishat protestante.

### Mëso më shumë!

Në epokën e barokut, shumë muzikantë punonin nën patronazhin e oborreve mbretërore ose kishave, ku merrnin pagë dhe ishin pjesë e ansambleve muzikore. Disa prej tyre madje krijonin muzikë posaçërisht për ngjarje të caktuara, si festa apo ceremoni, dhe shpesh duhej të përmbushnin kërkesat e patronëve të tyre, gjë që i bënte të punonin nën presion të madh – por njëkohësisht, krijuan disa nga veprat më të mëdha muzikore të të gjitha kohërave.

### Aktivitete:

#### 1. Diskutim: Format instrumentale të barokut

- Cilat forma instrumentale janë shfaqur në periudhën e barokut?
- Cila formë instrumentale e barokut është krijuar nga pjesë vallëzimi?
- Cila është karakteristika e *koncerto grosso*?
- Çfarë vepre është forma muzikore *concerti*?

#### 2. Me anë të dëgjimit muzikor bëni dallimin ndërmjet suitës dhe koncerto grosos

”Suitë orkestrale” nr. 3 në D-dur nga Johan Sebastian Bah



”Koncerto grosso” në g-mol op.6 nr.8 nga Arkanxhello Koreli





Dëgjoni shembujt muzikor!

Përgjigju pyetjeve të mëposhtme:

- Cila nga këto dy vepra ju tingëlloi më vallëzuese?
- Ku dëgjuat më shumë momente solistike?
- Cila vepër ju ngjau si një „bisedë” mes instrumenteve?
- A ju pëlqeu më shumë vepra nga Bahu apo ajo nga Koreli? Pse?

### 3. Dëgjimi i formave vokalo-instrumentale të barokut.

Shembull për dëgjim muzike – “Aleluja” (*Oratoriumi Mesia*) nga Hendeli



Shembull për dëgjim muzike – Kantatë nga J. S. Bah



Shembull për dëgjim muzike – „Pasioni sipas Mateut” nga J.S. Bah



Shembull për dëgjim muzike – Korale nga J.S. Bah



Parashtro pyetje sipas zgjedhjes tënde në lidhje me fragmentet e dëgjuara muzikore.





## Paraqitja e operës



“Ura e Vjetër në Firencë” nga F.R. Santoro

Opera për herë të parë është shfaqur në qytetin italian Firencë në fund të shekullit XVI. Një grup muzikantësh, poetësh dhe mendimtarësh të njohur si **Kamerata fiorentinase** dëshironin të rikthenin artin e tragjedisë antike greke. Ata besonin se muzika duhet të ndjekë dhe të shprehë emocionet e tekstit. Kështu u krijua një formë e re – opera, ku muzika, poezia dhe teatri bashkohen në një tërësi.

Opera e parë është “**Dafne**” nga **Jakopo Peri**, e interpretuar në Firencë në vitin 1597 dhe në thelb paraqet një pastorale, ku solistët vokal interpretojnë dialogje me mbështetje instrumentale. Premiera e “Dafne”-s ngjalli interes dhe admirim te publiku i aristokracisë, gjë që çoi në zhvillimin e shpejtë të operës si formë artistike.

Në vazhdim u krijuan edhe shumë opera të tjera, të cilat u bënë zhanër i dashur argëtimi në oborret dhe teatrot evropiane.

Pas lindjes së saj në Firencë, opera filloi të përhapej me shpejtësi edhe në qytete të tjera italiane – fillimisht në Romë, pastaj në Venedik dhe Napoli, e prej aty në mbarë Evropën – në Gjermani (Henri Shytc me operën „Dafne”), Angli (Henri Persëll me operën „Didona dhe Eneu”) dhe në Francë (Zhan Baptist Lyli me operën „Alceste”).



*Klaudio Monteverdi*

Kompozitori më i shquar i kësaj periudhe është **Klaudio Monteverdi** (it. *Claudio Monteverdi*) (1567 - 1643). Ndryshe nga kompozitorët e tjerë të kohës së tij, Monteverdi solli ide të reja në operë. Ariet dhe duetet e tij karakterizohen nga melodi më të zhvilluara dhe harmoni më të pasur. Ai besonte se muzika mund të shprehë të gjitha ndjenjat njerëzore, ndaj në operat e tij paraqiten emocione si dashuria, trishtimi, gëzimi dhe dhimbja. Monteverdi i jep një rol të veçantë orkestrës, jo vetëm si shoqëruese, por edhe si pjesë e zhvillimeve dramatike. Për këtë arsye, në historinë e muzikës Monteverdi konsiderohet si reformatori i parë i madh i operës.

Një nga operat më të njohura të tij është „Orfeu”, e cila veçohet për pasurinë muzikore dramatike, shprehëse dhe inovative. Në këtë operë, ndjenjat e personazheve paraqiten në mënyrë shumë bindëse, ndërsa orkestra përbëhet nga rreth 40 instrumente të ndryshme – diçka shumë e pazakontë për atë kohë. Në vend të një orkestre të organizuar si sot, këtu janë përdorur instrumente nga periudha mesjetare, që i japin kësaj opere një ngjyrë tingulluese të veçantë dhe unike.



*Fragment nga partitura e operës “Orfeu“ nga K. Monteverdi*

## Mëso më shumë!

Opera “Orfeu” (*L’Orfeo*) e Klaudio Monteverdit konsiderohet opera e parë që është ruajtur me partiturën e plotë, gjë që e mundëson interpretimin e saj edhe sot, thuajse në formën origjinale. Ajo u shfaq për herë të parë në vitin 1607 në Mantova.

## Aktivite:

### 1. Përgjigjuni gojarisht pyetjeve të parashtruara!

Ku u shfaq për herë të parë opera?

- a) Romë
- b) Venedik
- c) Firencë
- ç) Paris

Çfarë synonte të arrinte Kamerata fiorentinase?

- a) Të krijonte një muzikë të re popullore
- b) Të ringjallte tragjedinë e lashtë greke përmes muzikës
- c) Të thjeshtonte stilin polifonik
- ç) Të krijonte një lloj të ri të muzikës instrumentale

Kush e kompozoi operën e parë “Dafne”?

- a) Vinçenco Galilei
- b) J.S. Bahu
- c) Klaudio Monteverdi
- ç) Jakopo Peri

Cili kompozitor konsiderohet si reformatori i operës?

- a) Vivaldi
- b) Hendel
- c) Monteverdi
- ç) Bethoveni

Si quhet opera e njohur e Monteverdit në të cilën përfshihen 40 instrumente?

- a) Armida
- b) Orfeu
- c) Karmen
- ç) Toska

### 2. Dëgjo shembujt muzikorë dhe krahaso përdorimin e instrumenteve të njëri dhe të kompozitorit tjetër!

“Tu dormi, e’l nil dolce sonno“ – Jakopo Peri

Fragment nga opera “Orfeu” – Klaudio Monteverdi





## Georg Fridrih Hendel (1685–1759)



G. F. Hendel

Georg Fridrih Hendel (dt. *Georg Friedrich Händel*) ishte një nga kompozitorët më të rëndësishëm të barokut. I lindur më 23 shkurt 1685 në qytetin Hale, Gjermani. Hendeli ka udhëtuar dhe ka punuar në shumë vende. Ndërron jetë në Londër në vitin 1759, ku edhe është varrosur në Katedralen e Westminsterit – një nder që u jepet vetëm personaliteteve më të respektuara në Angli.

Hendeli, që në moshë të hershme, tregoi dashuri për muzikën, por babai i tij nuk dëshironte që ai të bëhej muzikant. Megjithatë, Hendeli ushtronte fshehurazi në piano dhe organo dhe me kalimin e kohës u bë një virtuoz i vërtetë. Ai studioi muzikë në Hale, pastaj shkoi në Itali, ku u njoh me stilin e operës italiane dhe muzikës kishtarë.

Pas disa vitesh, Hendeli u shpërngul në Londër, ku qëndroi deri në fund të jetës së tij. Aty u bë shumë i njohur si kompozitor i operave dhe më vonë edhe i oratoriumeve.

Muzika e Hendelit është madhështore, e qartë dhe jashtëzakonisht shprehëse. Në krijimtarinë e tij, ai përdor shpesh kontraste dinamike (*forte/piano*), ndryshime në tempo, melodi të qarta dhe shumë pjesë korale që theksojnë ndjeshëm karakterin dramatik të veprave të tij. Muzika e tij është plot energji dhe shpesh ngjall emocione të fuqishme.

Vepra më e njohur e Hendelit është oratoriumi „**Mesia**”, i cili sot interpretohet në të gjithë botën.

Përveç kësaj, ai ka shkruar edhe këto vepra shumë të njohura: operën „**Rinaldo**”, suitën orkestrale „**Muzikë në ujë**”, suitën orkestrale „**Muzika për fishekzjarre mbretërore**” dhe të tjera.

Opera „**Rinaldo**” – ishte opera e shkruar posaçërisht për publikun anglez (1711), e cila përmban shumë skena efektive, arie të bukura dhe momente magjike. Aria më e njohur është “**Më lër të qaj**” (*Lascia ch'io pianga*).

„**Muzika në ujë**” (*Water Music*) është suitë orkestrale e shkruar për një rast të veçantë, kur mbreti dhe oborri i tij organizonin një lundrim në lumin Temza. Vepra karakterizohet nga një frymë festive dhe solemne, që është në përputhje me qëllimin e saj.



“Më lër të qaj” - partitura origjinale e Hendelit



“Muzikë për fishekzjarret mbretërore” (*Music for the Royal Fireworks*) – një tjetër suitë e njohur, e shkruar për një festë të madhe mbretërore.

Hendeli ishte shumë i vlerësuar në kohën e tij. Ai edhe sot konsiderohet si një nga kompozitorët më të mëdhenj në histori. Ai e pasuroi muzikën angleze dhe vendosi themelet për zhvillimin e artit vokal dhe atij koral.

### Mëso më shumë!

- “Rinaldo” është një operë e Georg Fridrih Hendelit, kompozuar në vitin 1711 dhe ishte opera e parë në gjuhën italiane e shkruar posaçërisht për skenën e Londrës. Kur opera u shfaq për herë të parë në Londër, në skenë kishte pëllumba të vërtetë, fishekzjarre dhe shpatë! Njëri nga aktorët madje huazoi një shpatë nga mbreti Xhorxh I për skenën, por mbreti ishte aq i mahnitur, sa që nuk u zemërua, por qeshi!

- Gjatë premierës së interpretimit të korit „Aleluja” nga oratori „Mesia” i Hendelit, mbreti Xhorxh II u ngrit në këmbë, i prekur nga madhështia e muzikës. Sipas protokollit, edhe publiku u ngrit në këmbë. Kjo traditë praktikohet edhe sot – publiku ngrihet në këmbë kur interpretohet „Aleluja”.

### Aktivitet:

#### 1. Dëgjo shembujt e dhënë muzikorë dhe pastaj bëj dallimin lidhur me tempon, karakterin dhe mënyrën e interpretimit!

- Aria “Më lër të qaj” (*Lascia ch'io pianga*) nga opera “Rinaldo”



- Fragment nga suita “Muzikë në ujë” (*Water Music*)



- Pjesa korale “Aleluja” (*Hallelujah*) nga oratori “Mesia” (*Messiah*)





## Johan Sebastian Bah (1685–1750)



J. S. Bah

Johan Sebastian Bahu (dt. *Johhan Sebastian Bach*) është një nga kompozitorët më të mëdhenj në historinë e muzikës perëndimore. Lindi më 31 mars 1685 në qytetin Ajzenah të Gjermanisë dhe konsiderohet një nga gjenitë më të shquar të muzikës së periudhës së barokut. Vjen nga një familje e madhe muzikantësh. Prindërit dhe të afërmit e tij kanë qenë muzikantë të njohur. Që në moshë të hershme filloi të merrej me muzikë dhe studioi piano, organo dhe violë. Pas një kohe, Bah u bë organist, mësues dhe koncert-mjeshtër në qytete të ndryshme të Gjermanisë, përfshirë edhe Lajpcigun, ku kaloi vitet e fundit të jetës së tij. Bahu kishte 20 fëmijë, prej të cilëve shumica u bënë muzikantë dhe e vazhduan trashëgiminë e tij muzikore. Edhe pse Bahu ishte shumë i vlerësuar gjatë jetës së tij, ndikimi i tij i madh në muzikë u njoh dhe u vlerësua shumë më tepër pas vdekjes së tij.

Muzika e Bahut është e njohur për strukturën e saj të përbërë dhe për thellësinë emocionale dhe artistike. Trashëgimia e tij përfshin më shumë se 1000 vepra - kompozime vokalo-instrumentale, instrumentale dhe pjesë për piano (organo). Një nga aftësitë e tij më të spikatura ishte përdorimi mjeshtëror i **polifonisë**.



Partiturë origjinale e J.S.Bahut

Veprat e tij më të njohura janë: „Mesha në h-mol”, „Koncertet e Brandenburgut”, „Klaviçembali i tempuar mirë”, „Arti i fugës”, „Pasioni sipas Mateut” dhe të tjera.

„Mesha në h-mol” është një nga veprat më të mëdha muzikore të Bahut, krijuar në vitet e fundit të jetës së tij, ku në mënyrë të përkryer kombinon korin, solistët dhe orkestrën. Kjo vepër konsiderohet si një nga veprat më të rëndësishmet të muzikës së barokut.

“Koncertet e brandenburgut” janë një seri prej gjashtë koncertrash për përbërje të ndryshme instrumentale, të karakterizuara me nivel të lartë teknik, shumëllojshmëri stilesh dhe orkestrim brilant. Me këto koncerte, Bahu tregon virtuozezin e tij si kompozitor dhe orkestrues („Badineria” është një nga kompozicionet më të njohura dhe më dinamike nga “Koncertet e Brandenburgut”, interpretohet si një vepër e shpejtë dhe energjike dhe është e njohur për gëzueshmërinë dhe ritmin e saj).

“Klaviçembali i tempuar mirë” është koleksion prej dy librave me gjithësej 48 **preludime dhe fuga** për piano, të shkruara në të gjitha tonalitetet (dur dhe mol).

“**Arti i fugës**” është një seri prej 14 fugash dhe kanonesh, ku Bahu i eksploron dhe zhvillon teknikat e polifonisë. Muzika karakterizohet nga një kompleksitet i madh, me ndërthurje të temës në më shumë zëre. Kjo vepër është një shembull gjenial i përsosmërisë kompozicionale të Bahut.

“**Pasioni sipas Mateut**” është një nga veprat më të rëndësishme vokalo-instrumentale të Bahut. Aria „Mëshirohu” (*Erbarne dich*) është shumë emocionale dhe interpretohet nga soprani. Është një moment i thellë emocional, me muzikë që shpreh dhimbjen dhe vuajtjen e personazheve.

Bahu jo vetëm që i zhvilloi mjetet shprehëse muzikore të stilit barok, por vendosi edhe themelet për zhvillimin e mëtejshëm të muzikës klasike. Ndikimi i tij është i thellë dhe i përhershëm.

Edhe pse gjatë jetës së tij nuk ishte dhe aq i njohur sa sot, pas vdekjes Bahu u vlerësua si një nga kompozitorët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Muzika e tij ka ndikuar në shumë breza kompozitorësh dhe veprat e tij konsiderohen ndër më të bukurat në historinë e muzikës klasike botërore.

### Mëso më shumë!

- Është interesante që, edhe pse Bahu dhe Hendeli kanë lindur në të njëjtin vit (1685) dhe në një largësi relativisht të vogël nga njëri-tjetri, ata nuk janë takuar kurrë. Bahu madje u përpoq ta takonte Hendelin, por pa sukses.

- Johan Sebastian Bah ishte i njohur për aftësinë e tij të jashtëzakonshme për improvizim. Mbreti Fridrih II i Prusisë e ftoi Bahun në oborrin e tij dhe i dha një temë muzikore shumë të komplikuar, duke e sfiduar të improvizonte. Askush nuk priste që Bahu do të arrinte, por pas dy muajsh ai krijoi koleksionin e melodive “Flijimi muzikor”, ku ia doli të përmbushë kërkesën e ndërlikuar të mbretit.

### Aktivitet:

**1. Dëgjo shembujt muzikorë të J. S. Bahut, e më pas bëj dallimin në lidhje me tempon, karakterin dhe mënyrën e interpretimit!**

“Badineria”



“Preludium dhe Fugë” në c-mol



“Koncertet brandenburgeze”



Aria “Mëshirohu” (*Erbarne dich*) nga „Pasioni sipas Mateut”





## Antonio Vivaldi (1678–1741)




A. Vivaldi

A. Vivaldi (*it. Antonio Vivaldi*) ishte një nga kompozitorët e shquar të epokës së barokut, me ndikim të thellë në zhvillimin e muzikës së kësaj periudhe. Lindi më 4 mars 1678 në Venedik, në Itali, në një familje muzikantësh, ku babai i tij ishte violinist dhe mësuesi i parë i Antonios. Që i vogël, Vivaldi tregoi dashuri të madhe për muzikën, sidomos për violinën, instrumenti që më vonë do ta bënte të famshëm në gjithë Evropën.

Edhe pse u bë prift, Vivaldi iu përkushtua më shumë muzikës. Për shkak të ngjyrës së kuqe të flokëve, mori nofkën „Prifti i Kuq” (*Il Prete Rosso*). Pjesën më të madhe të jetës e kaloi si mësues dhe kompozitor në një shkollë femrash në Venecia (*Ospedale della Pietà*), ku krijonte muzikë për orkestrën e vajzave – nxënese jashtëzakonisht të talentuara.

Muzika e Vivaldit është e gëzueshme, plot ngjyra dhe me gjallëri të veçantë. Ai ishte mjeshtër i dalluar i melodisë dhe i zhvilloi format e koncertit, veçanërisht koncertin solistik (ku solo instrumenti përcillet nga orkestra).

Vepra e tij më e njohur është cikli me katër koncerte për violinë “**Stinët e vitit**” – secili koncert përfaqëson një stinë të vitit (“Pranvera”, “Vera”, “Vjeshta” dhe “Dimri”) dhe përmban tinguj të natyrës, peizazhe dhe ngjarje (rrufe, shi, zogj, gjueti...) të përshkruara nëpërmjet muzikës. Këto koncerte janë shembulli i parë i muzikës programatike – kur nëpërmjet titullit të kompozimit muzikor përcaktohet përmbajtja, idea ose disponim i pjesës. Përveç tyre, Vivaldi ka shkruar edhe mbi 500 koncerte (për violinë, flaut, instrumente harkore dhe të tjerë), muzikë kishtare, si dhe mbi 40 opera, disa prej të cilave qenë shumë të njohura edhe në kohën e tij.



Partiturë nga Vivaldi



## Mëso më shumë!

- Edhe pse ishte shumë i famshëm gjatë jetës së tij, Vivaldi vdiq në varfëri në Vjenë dhe ra në harresë për gati 200 vjet, deri në shekullin XX, kur muzika e tij u bë sërish e njohur.
- Vivaldi gjithashtu ishte një inovator – ai është ndër kompozitorët e parë të muzikës programatike (*Stinët e vitit*).
- Nxënëset e shkollës ku ai punonte interpretonin veprat e tij pas grilave, sepse publiku nuk kishte leje t’i shihte drejtpërdrejt vajzat.

## Aktivitete:

**1. Dëgjo shembullin e dhënë dhe përshkruaj se si Antonio Vivaldi arriti ta portretizojë pranverën me muzikën e tij!**



**2. Hulumtojmë të dhëna interesante rreth krijimtarisë së kompozitorëve**

- Ndahuni në tri grupe:

Grupi **A**: Hulumto të dhëna interesante nga krijimtaria e G.F. Hendelit

Grupi **B**: Hulumto të dhëna interesante nga krijimtaria e J.S. Bahut

Grupi **C**: Hulumto të dhëna interesante nga krijimtaria e A. Vivaldit

Përgatitni një prezantim në *powerpoint*.





## DËGJIM I UDHËZUAR



Dëgjimi i udhëzuar paraqet ndjekjen e kujdesshme të veprës muzikore përmes dëgjimit, me qëllim që të identifikohet autori, titulli, interpretuesi dhe përbërja e interpretuesve. Gjatë dëgjimit duhet t'u kushtohet vëmendje mjeteve shprehëse muzikore si p.sh.:

- *Tempo* – shpejtësia e interpretimit të muzikës;
- *Dinamika* – fuqia e tingujve (toneve muzikore);
- *Melodia* – ide muzikore e krijuar nga varg tingujsh;
- *Ngjyra e instrumentit (timbri)* – tingulli karakteristik i një instrumenti;
- *Ngjyra e zërit* – cilësia karakteristike e tingullit të zërit që e bën të dallueshëm dhe të ndryshëm nga zërat e tjerë;
- *Forma muzikore* – struktura dhe organizimi i një vepre muzikore;
- *Karakteri* – mënyra se si tingëllon vepra ose interpretimi dhe çfarë disponimi, emocioni ose përshtypjeje shkakton te dëgjuesi, etj.

Me dëgjim të udhëzuar mund ta kuptojmë më mirë interpretimin e kompozimit dhe të vlerësojmë llojin dhe numrin e instrumenteve, nuancat dinamike, tempon, përgatitjen teknike të interpretuesve dhe ekspresivitetin e tyre.

## Mëso më shumë!

### Fonografi i Tomas Edison (eng. *Thomas Edison*) – fillimi i dëgjimit të muzikës në shtëpi

Amerikani Tomas Edison (1847–1931) është një nga shpikësit më të mëdhenj në histori. Për shkak të aktivitetit të tij të pasur shpikës, shpesh quhej “Magjistari i Menlo Park”, sipas laboratorit ku krijoi shumë nga shpikjet e tij. Gjatë jetës, Edison arriti të regjistrojë deri në 1 093 patente – një shifër vërtet e jashtëzakonshme për një individ.

Mes shpikjeve të tij më të rëndësishme veçohet fonografi i vitit 1877, pajisja e parë që mundësoi regjistrimin dhe riprodhimin e tingullit (muzikës) dhe të zërit njerëzor. Kjo shpikje revolucionare lejoi ruajtjen e materialit tingullor që deri atëherë mund të dëgjohej vetëm gjatë momentit të interpretimit. Fonografi shënon fillimin e teknologjisë së tingullit. Më pas u shpikën gramafoni, magnetofoni, kasetofoni, kompakt disku (CD), format digjitale dhe platformat moderne për muzikë si mp3 dhe shërbimet e transmetimit online.



*T. Edisoni me fonograf*



*Bartës të tingullit*

# 2. TEORIA E MUZIKËS NËPËRMJET PRAKTIKËS

## PËRMBAJTJE:

- Shkallët dhe intervalet
- Ritmi, metri dhe takti
- Aplikacione për shkrimin e notave



## Koncepte kyçe:

- sistemi tingullor, oktava, çelësi i violinës, çelësi i basit, diezi, bemoli, bekuadri, gjysmëtoni, toni, një ton e gjysmë, tetrakordi, grada, shkallë dur, C-dur, a-mol, G-dur, e-mol, F-dur, d-mol, shkallët mol: natyral, harmonik dhe melodik, shkallë paralele; prima, sekunda, terca, kuarta, kuinta, seksta, septima, oktava
- vlerat e notave, takte të rregullta (me ndarje të barabarta): takti dypjesor, tripjesor dhe katërpjesor me ndarjen në dy pjesë të njësisë matëse; takte të parregullta (me ndarje jo të barabarta): takte me njësi matëse notën tetëshe

## Do të mësosh:

- t'i dallosh, krahasosh dhe analizosh karakteristikat e shembujve tingullorë duke shpjeguar elementet e tyre shprehëse (vizualisht dhe në mënyrë dëgjimore – shkallë deri në një parashenjë me të gjitha elementet e saj) dhe i përdor ato përmes këndimit/luajtjes së këngëve dhe ushtrimeve njëzërëshe dhe dyzërëshe, duke aplikuar edhe shkrimin muzikor;
- t'i dallosh nëpërmjet dëgjimit dhe të zbatosh taktet e rregullta (me ndarje të barabarta) dhe taktet e parregullta (me ndarje jo të barabarta), nëpërmjet shembujve të njohur muzikorë me ritme dhe metër të ndryshëm muzikor;
- të përdorësh aplikacione për shkrimin muzikor duke zbatuar elementet e mësuara muzikore (çelësat, shkallët me të gjitha elementet e saj, intervalet dhe llojet e takteve).





# SHKALLËT DHE INTERVALET

## Sistemi tingullor dhe oktavat

Të gjitha tingujt që ekzistojnë në muzikë janë të radhitur në një varg tingujsh, që e quajmë **sistem tingullor** (tonal). Në këtë sistem, shtatë tingujt bazë (c, d, e, f, g, a, h) përsëriten disa herë, por gjithmonë në lartësi të ndryshme – nga tingulli më i ulët deri te tingulli më i lartë.

Për ta pasur më të lehtë t'i dallojmë këto përsëritje, sistemi tingullor ndahet në **oktava**. Një oktavë përfshin shtatë tinguj radhazi, p.sh. c, d, e, f, g, a, h, dhe secila oktavë ka emrin e vet të veçantë, në varësi të vendit që zë në sistemin tingullor.

Emrat e oktavave janë si më poshtë:

**Oktava subkontër (tepër e ulët):** 2C, 2D, 2E, 2F, 2G, 2A, 2H

**Oktava kontër (e ulët):** 1C, 1D, 1E, 1F, 1G, 1A, 1H

**Oktava e madhe:** C, D, E, F, G, A, H

**Oktava e vogël:** c, d, e, f, g, a, h


**Oktava e parë:** c<sup>1</sup>, d<sup>1</sup>, e<sup>1</sup>, f<sup>1</sup>, g<sup>1</sup>, a<sup>1</sup>, h<sup>1</sup>

**Oktava e dytë:** c<sup>2</sup>, d<sup>2</sup>, e<sup>2</sup>, f<sup>2</sup>, g<sup>2</sup>, a<sup>2</sup>, h<sup>2</sup>


**Oktava e tretë:** c<sup>3</sup>, d<sup>3</sup>, e<sup>3</sup>, f<sup>3</sup>, g<sup>3</sup>, a<sup>3</sup>, h<sup>3</sup>

**Oktava e katërt:** c<sup>4</sup>, d<sup>4</sup>, e<sup>4</sup>, f<sup>4</sup>, g<sup>4</sup>, a<sup>4</sup>, h<sup>4</sup>

**Oktava e pestë (më e larta):** c<sup>5</sup>, d<sup>5</sup>, e<sup>5</sup>, f<sup>5</sup>, g<sup>5</sup>, a<sup>5</sup>, h<sup>5</sup>



2A 2H 1C 1D 1E 1F 1G 1A 1H C D E F G A H c d e f g a h c<sup>1</sup> d<sup>1</sup> e<sup>1</sup> f<sup>1</sup> g<sup>1</sup> a<sup>1</sup> h<sup>1</sup> c<sup>2</sup> d<sup>2</sup> e<sup>2</sup> f<sup>2</sup> g<sup>2</sup> a<sup>2</sup> h<sup>2</sup> c<sup>3</sup> d<sup>3</sup> e<sup>3</sup> f<sup>3</sup> g<sup>3</sup> a<sup>3</sup> h<sup>3</sup> c<sup>4</sup>







**Mëso më shumë!**

Zëri i njeriut ka shtrirjen e vet, i cili varet nga gjinia dhe lloji i zërit. Zakonisht, zëri lëviz brenda oktavave në vijim:

**Zëra mashkullorë** (bas, bariton, tenor): nga **E** (oktava e madhe) deri te **g<sup>1</sup>** (oktava e parë)

**Zëra femërorë** (alt, mezo-soprano, soprano): nga **f** (oktava e vogël) deri te **c<sup>3</sup>** (oktava e tretë)

Nga ana tjetër, veshi i njeriut ka një aftësi të jashtëzakonshme – mund të dëgjojë tinguj nga rreth 20 Hz deri në 20000 Hz, që do të thotë një shtrirje që përfshihet nga nën-subkontra oktava e deri në oktavën e pestë e më lart!

Kjo do të thotë se jemi në gjendje të dëgjojmë edhe tinguj që nuk mund t’i këndojmë – veçanërisht ato tinguj jashtëzakonisht të ulët ose të lartë që i prodhojnë instrumentet, kafshët apo pajisjet elektronike.

Instrumentet muzikore kanë aftësinë t’i interpretojnë të gjithë tingujt e sistemit tingullor. Çdo instrument ka diapazonin e vet, pra pjesën e sistemit tingullor që mund të mbulojë gjatë interpretimit.

Për shembull, pianoja, si instrumenti me diapazonin më të gjerë, përfshin pothuajse të gjithë tingujt nga subkontra deri në oktavën e pestë.

Instrumente të tjera, siç janë violina, flauti, klarineta apo tromboni, kanë diapazone të ndryshme, por së bashku, ato mundësojnë një përfshirje të plotë të sistemit tingullor.

Prandaj, arti muzikor përmes interpretimit instrumental ka mundësi të pakufizuara të shprehjes.

**Aktivitet:**

**1. Shkruaji në fletore tonet e oktavave të mëposhtme duke përdorur alfabetin muzikor:**

- Oktava kontra \_\_\_\_\_
- Oktava e madhe \_\_\_\_\_
- Oktava e vogël \_\_\_\_\_
- Oktava e dytë \_\_\_\_\_



## Emërtimi i tingujve në çelësin e violinës dhe basit

Siç e dimë, shenjat me të cilat shënohen tingujt quhen nota dhe ato shkruhen në sistemin vizor (pentagram). Që të mund t'i përcaktojmë saktë emrat e notave (sipas alfabetit ose solmizimit) në sistemin vizor, në fillim të çdo sistemi vendosim një çelës – çelës violine ose çelës basi (si dhe çelësa tjerë muzikor).

Notat në çelësin e violinës:

g a h c<sup>1</sup> d<sup>1</sup> e<sup>1</sup> f<sup>1</sup> g<sup>1</sup> a<sup>1</sup> h<sup>1</sup> c<sup>2</sup> d<sup>2</sup> e<sup>2</sup> f<sup>2</sup> g<sup>2</sup> a<sup>2</sup>  
sol la si do<sup>1</sup> re<sup>1</sup> mi<sup>1</sup> fa<sup>1</sup> sol<sup>1</sup> la<sup>1</sup> si<sup>1</sup> do<sup>2</sup> re<sup>2</sup> mi<sup>2</sup> fa<sup>2</sup> sol<sup>2</sup> la<sup>2</sup>

Notat në çelësin e basit

E F G A H c d e f g a h c<sup>1</sup> d<sup>1</sup> e<sup>1</sup> f<sup>1</sup>  
MI FA SOL LA SI do re mi fa sol la si do<sup>1</sup> re<sup>1</sup> mi<sup>1</sup> fa<sup>1</sup>

### Aktivitete:

#### 1. Ushtrime për leximin e notave në çelësin e violinës:



2. Ushtrime për leximin e notave në çelësin e basit:

The image shows three staves of musical notation in bass clef. The first staff contains a sequence of notes: C2, D2, E2, F2, G2, A2, B2, C3. The second staff contains: C3, D3, E3, F3, G3, A3, B3, C4. The third staff contains: C4, D4, E4, F4, G4, A4, B4, C5. Each note is a half note.

**Tinguj të ngritur dhe të zbritur – shenjat e shartimit (diezi, bemoli dhe bekuadri)**


Brenda sistemit të toneve, përveç toneve bazë (natyrorë), hasen edhe variante më të larta ose më të ulëta të atyre toneve. Këto ndryshime bëhen përmes simboleve të veçanta muzikore që quhen **shenja të shartimit**.

Shenja që përdoret për ngritjen e lartësisë së një toni quhet **diezi (#)**. Ajo vendoset para notës, në të njëjtën vijë ose hapësirë ku ndodhet nota, dhe e ngren lartësinë e saj për gjysmë toni (semiton). Kur një ton ngritet me diez, emrit të tij i shtohet prapashtesa **is** (për shembull: nga C fitohet Cis).

A musical staff in treble clef showing notes with sharp signs (#) on the lines. Below the staff, the letter names are listed: C Cis, D Dis, E Eis, F Fis, G Gis, A Ais, H His.

**Shenja që përdoret për uljen e lartësisë së një toni quhet bemol (b)**. Kjo shenjë, ashtu si diezi, vendoset para notës, në të njëjtën vijë ose hapësirë ku është shkruar nota, dhe e ul lartësinë e saj për gjysmë toni (semiton). Kur një ton ulet me bemol, emrit të tij i shtohet prapashtesa **es** (për shembull: nga D fitohet Des).

A musical staff in treble clef showing notes with flat signs (b) on the lines. Below the staff, the letter names are listed: C Ces, D Des, E Es, F Fes, G Ges, A As, H Hes (B).



Në fotografinë e sipërme, me ndihmën e tastierës së pianos, shpjegohen tonet e ngritura dhe të zbritura.

Përveç shenjave për ngritje dhe zbritje, ekziston edhe një shenjë që shërben për të anuluar veprimet e tyre, duke e kthyer notën në gjendjen e saj të mëparshme. Kjo shenjë quhet **bekquadri** (♮).

Bekquadri vendoset para notës dhe e kthen atë në lartësinë e saj natyrore. Me fjalë të tjera, nëse donjë notë më parë është ngritur me diez apo është zbritur me bemol, bekuadri e anulon atë veprim dhe ia rikthen emrin fillestar.

Shembull: nëse nota Fis neutralizohet me bekuadër, ajo bëhet sërish F; ose Es bëhet E.



### Aktivitet:

#### 1. Pyetje:

- Çfarë ndodh me tonin nëse para tij është shenja # (diez)?
- Çfarë do të thotë ♭ para tonit E?
- Nëse toni Fis është ndryshuar me shenjën ♮, cili ton do të luhet?
- Cili është efekti i bekuadrit (♮) mbi një ton që më parë ka pasur diez ose bemol?
- Shkruaj në fletore 3 tone me diez dhe 3 me bemol:

Diez: \_\_\_\_\_  
Bemol: \_\_\_\_\_



## Shkalla muzikore dhe elementet e saj

**Shkalla muzikore** përbëhet nga shtatë tinguj të radhitur sipas alfabetit muzikor, ku tingulli i parë përsëritet si tingulli i tetë i shkallës.

Elementet e shkallës muzikore janë:

**Grada** është vendi i një toni në një shkallë muzikore. Gradët shënohen me numra romakë (I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII).

**Gjysmëtoni (Semitoni)** është distanca më e vogël ndërmjet dy gradëve fqinje. Shënohet me 1/2.

**Toni** është përbërë nga dy gjysmëtone. Shënohet me 1/1.

**Tetrakordi** paraqet ndarjen e një shkalle muzikore në dy pjesë të barabarta. Çdo shkallë muzikore ka një tetrakord të parë ose të poshtëm, i cili përfshin gradët I, II, III dhe IV, dhe një tetrakord të dytë ose të sipërm, që përfshin gradët V, VI, VII dhe VIII.

Emërtimi i tingujve në një shkallë muzikore bëhet në dy mënyra: me solmizim dhe me alfabet.

Solmizimi është një sistem emërtimi me rrokje: do, re, mi, fa, sol, la, si, që përdoren veçanërisht për qëllime edukative, për të ndihmuar në intonimin dhe njohjen më të lehtë të tingujve.

Alfabeti muzikor, nga ana tjetër, përdor shkronjat e alfabetit latin: A, B, C, D, E, F, G, ku **C** përkon me **do**, **D** me **re**, dhe kështu me radhë. Ky sistem përdoret kryesisht në analizën teorike, literaturën me nota dhe në kontekst ndërkombëtar.

Të dy sistemet janë komplementare dhe që të dyja përdoren në mësimin e muzikës.

### C-dur (Shkalla themelore)

Shkalla që fillon dhe përfundon me tingullin me **c** quhet shkalla C-dur. Shkalla C-dur është shkalla themelore muzikore.

**Tetrakordi i parë (i poshtëm)**      **Tetrakordi i dytë (i sipërm)**

1/1    1/1                      1/1    1/1    1/1

Solmizim:	do	re	mi	fa	sol	la	si	do
Alfabet:	c	d	e	f	g	a	h	c
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII


**Tetrakordi i parë (poshtëm)** 1/1,1/1,1/2

**Tetrakordi i dytë (sipërm)** 1/1, 1/1, 1/2

**Semiton (Gjysmëton)** 1/2

**Ton** 1/1





Solmizim:	do	re	mi	fa	sol	la	si	do
Alfabet:	c	d	e	f	g	a	h	c
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

Shembull: temë në C-dur

**Oda e Gëzimit**  
pjesë nga Simfonia e IX e Ludvig van Betoven



### Mëso më shumë!

Shkallët dur në tingëllimë kanë një karakter të ndritshëm, të gëzueshëm dhe optimist. Prandaj, kur i dëgjoni, do të ndjeni emocion pozitiv.

### Aktivitet:

1. Shkruaje në fletore shkallën C-dur me të gjitha karakteristikat e saj!

### Shkallët mol

Çdo shkallë dur ka shkallën e saj paralele mol. Shkalla mol fitohet duke u nxjerrë nga shkalla dur. Merret grada e saj e gjashtë, e cila bëhet grada e parë, dhe pastaj radhiten tonet e shkallës së krijuar mol. Kështu grada e gjashtë e shkallës dur bëhet grada e parë e shkallës mol. Në këtë mënyrë fitohet një renditje tjetër e intervaleve të toneve dhe semitoneve, prandaj shkalla mol ka një ngjyrë tingëlluese të ndryshme nga ajo dur.

Për shembull, toni i gjashtë në shkallën C-dur është toni **a**. Nëse nga ai ton ndërtojmë një shkallë të re me të njëjtët tinguj si C-dur, fitohet shkalla a-mol. Kjo shkallë e re është paralele me C-dur, sepse ka të njëjtët tinguj dhe nuk ka ndonjë parashenjë.

I II III IV V VI VII VIII  
c d e f g a h c

I II III IV V VI VII VIII  
a h c d e f g a

### Mëso më shumë!

- Shkallët mol kanë një karakter tingullor të butë, melankolik dhe të ndjeshëm.
- Emri i shkallëve dur shkruhet me shkronjë të madhe (p.sh.: C-dur),
- Emri i shkallëve mol shkruhet me shkronjë të vogël (p.sh.: a-mol).



**Llojet e shkallëve mol:**

Në teorinë e muzikës ekzistojnë tre lloje kryesore të shkallëve mol:

1. **Shkalla mol natyrale** – ndërtohet pa asnjë ndryshim të tingujve.
2. **Shkalla mol harmonike** – ndryshon nga natyralja sepse grada e VII-të ngrihet për gjysmë toni.
3. **Shkalla mol melodike** – përdoren dy versione: gjatë ngjitjes, grada VI dhe VII ngrihen, ndërsa gjatë zbritjes përdoret shkalla mol natyrore.

**a-mol natyral**


Shkalla a-mol është shkallë paralele e shkallës C-dur.

Shkalla a-mol natyrale nuk ka asnjë tingull të ngritur ose të zbritur, ashtu si edhe shkalla C-dur. a-mol fillon dhe përfundon me tonin a dhe ndërtohet sipas kësaj radhitjeje të tingujve: a, h, c, d, e, f, g, a.

Në këtë shkallë, gjysmëtonet ndodhen midis gradës II–III (h–c) dhe V–VI (e–f).


**Tetrakordi i parë (i poshtëm)**

**Tetrakordi i dytë (i sipërm)**



Solmizim:	la	si	do	re	mi	fa	sol	la
Alfabet:	a	h	c	d	e	f	g	a
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

**Tetrakordi i parë (i poshtëm)**      **Tetrakordi i dytë (i sipërm)**



Solmizim:	do	re	mi	fa	sol	la	si	do	re	mi	fa	sol	la
Alfabet:	c	d	e	f	g	a	h	c	d	e	f	g	a
Gradët:						I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII



### a-mol harmonik

Në a-mol të llojit harmonik, grada e shtatë është e ngritur. Ajo fillon dhe përfundon me tingullin **a** dhe lëviz kështu: a, h, c, d, e, f, gis, a. Ngritja e **g** në **gis** krijon një distancë prej 1½ (një ton e gjysmë) ndërmjet gradës VI dhe VII.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

Solmizim:	la	si	do	re	mi	fa	sol #	la
Alfabet:	a	h	c	d	e	f	gis	a
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

### a-mol melodik

Shkalla a-mol melodike dallon gjatë ngjitjes dhe zbritjes. Gjatë ngjitjes, grada VI dhe VII ngrihen (**f** bëhet **fis** dhe **g** bëhet **gis**), ndërsa gjatë zbritjes përdoren tingujt natyral (**f** dhe **g**), ashtu si te shkalla mol natyrale.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)


Solmizim:	la	si	do	re	mi	fa#	sol #	la
Alfabet:	a	h	c	d	e	fis	gis	a
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

la	sol	fa	mi	re	do	si	la
a	g	f	e	d	c	h	a
VIII	VII	VI	V	IV	III	II	I



**Aktivitet:**

1. Shqyrto vijat melodike të dhëna dhe përcakto në fletore se cilit lloj të shkallës a-mol i përkasin!




**G-dur**

Shkalla G-dur fillon dhe përfundon me tingullin g.  
Përbëhet nga këta tinguj: g, a, h, c, d, e, fis, g.  
Ka një parashenjë – tingullin e ngritur **f (fis)**.

**Tetrakordi i parë (i poshtëm)**

**Tetrakordi i dytë (i sipërm)**



Solmizim:	sol	la	si	do	re	mi	fa#	sol
Alfabet:	g	a	h	c	d	e	fis	g
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII





Shembull: pjesë nga kompozimi në G-dur

**Menuet në G-dur**  
Johan Sebastian Bah

**Aktivitet:**

1. Shkruaje në fletore shkallën G-dur me të gjitha karakteristikat e saj!



### e-mol natyral

e-mol është shkalla paralele e G-dur, e-mol natyral fillon dhe përfundon me tonin e.

Përbëhet nga tingujt: e, fis, g, a, h, c, d, e.

Nuk ka tone të ngritur ose të zbritur (përveç **fis**, i cili është parashenjë nga shkalla paralele G-dur).

Përdor të njëjtët tinguj si G-dur, por fillon nga grada VI (toni e).

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

Solmizim:	mi	fa#	sol	la	si	do	re	mi
Alfabet:	e	fis	g	a	h	c	d	e
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

### e-mol harmonik

e-mol harmonik fillon dhe përfundon me tonin e. Përbëhet nga tingujt: e, fis, g, a, h, c, dis, e. Grada e shtatë **d** është e ngritur për gjysmë toni **dis** në krahasim me llojin natyral. Kjo ngritje bëhet për të krijuar një funksion harmonik midis gradës së VII dhe VIII.

Ngritja e **d** në **dis** krijon një distancë prej  $1\frac{1}{2}$  (një ton e gjysmë) midis gradës VI dhe VII.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

Solmizim:	mi	fa#	sol	la	si	do	re #	mi
Alfabet:	e	fis	g	a	h	c	dis	e
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII



### e-mol melodik

e-mol melodik fillon dhe përfundon me tonin e dhe ka përbërje të ndryshme të tingujve gjatë ngjitjes dhe zbritjes. Gjatë ngjitjes, grada VI dhe VII ngrihen (c bëhet cis dhe d bëhet dis), ndërsa gjatë zbritjes përdoren tingujt natyral (c dhe d), ashtu si në shkallën mol natyrore.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

Solmizim:	mi	fa#	sol	la	si	do#	re#	mi
Alfabet:	e	fis	g	a	h	cis	dis	e
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

Solmizim:	mi	re	do	si	la	sol	fa#	mi
Alfabet:	e	d	c	h	a	g	fis	e
Gradët:	VIII	VII	VI	V	IV	III	II	I

#### Aktivitet:

1. Shqyrto vijat melodike të dhëna dhe përcakto se cilit lloj të shkallës e-mol i përkasin!




### F-dur

Shkalla F-dur është shkallë dur që fillon dhe përfundon me tonin **f** dhe ka një ton të zbritur – **b** (*si-bemol*). Tingujt e shkallës F-dur janë: f, g, a, b, c, d, e, f.

F-dur ka një parashenjë, *bemol* (*b*) ose *si-bemol*.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)



Solmizim:	fa	sol	la	si $\flat$	do	re	mi	fa
Alfabet:	f	g	a	b	c	d	e	f
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

Shembull: pjesë nga kompozimi në F-dur

### Valle gjermane në F-dur Wolfgang Amadeus Mozart



#### Aktivitet:

1. Shkruaje në fletore shkallën F-dur me të gjitha karakteristikat e saj!



### d-mol natyral

d-mol është shkalla paralele e F-dur.  
 Lloji natyral i d-mol është shkallë mol që fillon dhe përfundon me tonin **d** dhe ndërtohet sipas modelit natyral të shkallës mol.  
 Tingujt e shkallës d-mol natyror janë: d, e, f, g, a, b, c, d.  
 Ka një parashenjë, *bemol* (  $\flat$  ) ose *si-bemol*.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

Solmizim:	re	mi	fa	sol	la	si $\flat$	do	re
Alfabet:	d	e	f	g	a	b	c	d
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

### d-mol harmonik

d-mol harmonik fillon dhe përfundon me tonin **d**.  
 Përbëhet nga tingujt: d, e, f, g, a, b, cis, d.  
 Grada e shtatë **c** është e ngritur për gjysmë toni në **cis**.  
 Ashtu si në shkallët e tjera mol harmonike, ngritja e gradës së VII (nga c në cis) krijon distancë prej një ton e gjysmë  $1\frac{1}{2}$  midis gradës së VI dhe VII.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

Solmizim:	re	mi	fa	sol	la	si $\flat$	do #	re
Alfabet:	d	e	f	g	a	b	cis	d
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII



### d-mol melodik

Në d-mol melodik, ashtu si në shkallët e tjera mol melodike, gjatë ngjitjes, grada e VI dhe VII ngrihen (**b** në **h** dhe **c** në **cis**), ndërsa gjatë zbritjes **h** kthehet në **b** dhe **cis** në **c**, njësoj si te shkalla mol natyrale.

#### Tetrakordi i parë (i poshtëm)

#### Tetrakordi i dytë (i sipërm)

Solmizim:	re	mi	fa	sol	la	si	do #	re
Alfabet:	d	e	f	g	a	h	cis	d
Gradët:	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII

Solmizim:	re	do	si b	la	sol	fa	mi	re
Alfabet:	d	c	b	a	g	f	e	d
Gradët:	VIII	VII	VI	V	IV	III	II	I

### Aktivitet:

1. Me përdorimin e melodisë së njëjtë, në fletore ndërto shkallën d-mol natyral, harmonik dhe melodik, duke i vendosur shenjat përkatëse të shartimit.

#### Lloji natyral

#### Lloji harmonik

#### Lloji melodik





## Intervalet

Intervali është largësia ndërmjet dy tingujve në muzikë. Në varësi të mënyrës se si interpretohen tingujt, intervallet ndahen në harmonike dhe melodike.


### Intervali harmonik

Intervali harmonik krijohet kur dy tinguj dëgjohen njëkohësisht, pra kur këndohen ose luhen në të njëjtën kohë.



### Intervali melodik

Intervali melodik krijohet kur dy tinguj dëgjohen njëri pas tjetrit, pra në mënyrë pasuese. Kjo është tipike për meloditë, ku tingujt renditen një pas një.




Intervallet themelore janë ato që nuk janë më të mëdha se një oktavë. Ato ndahen sipas numrit të tingujve (gradëve) që përfshijnë:

1. **Prima (1)** është largësia ndërmjet dy tingujve të njëjtë.



2. **Sekunda (2)** është largësia ndërmjet dy tingujve fqinj.



3. **Terca (3)** është largësia ndërmjet tre tingujve.





4. **Kuarta (4)** është largësia ndërmjet katër tingujve.



5. **Kuinta (5)** është largësia ndërmjet pesë tingujve.



6. **Seksta (6)** është largësia ndërmjet gjashtë tingujve.



7. **Septima (7)** është largësia ndërmjet shtatë tingujve.




8. **Oktava (8)** është largësia ndërmjet tetë tingujve.





**Aktivite:**

**1. Emëro këto intervale:**



**2. Nga takti 1 deri në 8, gjej sekundat, kuartat, sekstat dhe oktavat; nga takti 9 deri në 16, gjej primat, tercat, kuintat dhe septimat.**






# RITMI, METRI DHE TAKTI

## Piramida e vlerave të notave dhe pushimeve të tyre

Në muzikë, çdo notë ka vlerën e saj, gjegjësisht kohëzgjatjen e saj. Vlerat e notave tregojnë sa gjatë duhet të luhet ose këndohet një notë.

Piramida e vlerave të notave tregon hierarkinë e kohëzgjatjes së notave dhe pushimeve – nga vlera më e gjatë deri te ajo më e shkurtër.



### Aktivitete:

#### 1. Shkruaji në fletore notat e kërkuara sipas lartësisë dhe vlerave të tyre!

c1	g1	d1	h1	c2	a1	e1	f1
e plotë	tetëshe	gjashtëmbëdhjetëshe	gjysmë	katërshe	tetëshe	e plotë	katërshe

#### 2. Shkruaji pushimet në fletore!

katërshe	e plotë	tetëshe	gjysmë	gjashtëmbëdhjetëshe
----------	---------	---------	--------	---------------------

**3. Emërtoji notat dhe kohëzgjatjen e tyre!****4. Emërtoji notat dhe kohëzgjatjen e tyre!**

**Ritmi** (prej fjalës greke  $\rho\acute{\epsilon}\omega$  që do të thotë me rrjedhë) është një radhitje tingujsh me gjatësi të ndryshme.

**Mëso më shumë!**

Kur ecim, hapat tanë krijojnë një ritëm natyror – zakonisht rreth 2 hapa në sekondë. Ky ritëm është aq natyral, saqë shumë kompozitorë e kanë marrë frymëzimin pikërisht nga ecja dhe disa madje kanë kompozuar gjatë shëtitjes, si Mocarti apo Bethoveni! Herën tjetër kur të jesh duke shëtitur, provo të dëgjosh një këngë që përputhet me ritmin e hapave të tu – do të vëresh sa bukur përshtatet!

Në interpretimin muzikor, disa tinguj janë më të dallueshëm, pra janë më të theksuar, ndërsa të tjerët janë më të butë ose të patheksuar.

Në muzikë, vargu i tingujve të theksuar dhe të patheksuar quhet **metër muzikor**.

Metri mund të përbëhet nga një numër i ndryshëm i rrahjeve apo pjesëve të tij – zakonisht nga dy, tri, katër, e deri në dymbëdhjetë pjesë (rrahje).

Pjesët e theksuara të metrit quhen **tezë** (–), ndërsa ato të patheksuara quhen **arzë** (˘).



**Takti** është njësi themelore ndërtuese dhe pjesa më e vogël e një kompozimi muzikor që është e përcaktuar metrikisht.

Taktet ndahen nga njëra-tjetra me vija vertikale (vijat e taktit) të cilat vendosen në të gjithë sistemin e notave.

Në fund të veprës muzikore vendosen dy vija përfundimtare – njëra më e hollë dhe tjetra më e trashë – me të cilat shënohet fundi i kompozimit.



Ekzistojnë disa lloje të takteve, varësisht nga metri i cili shënohet menjëherë pas çelësit. Ndarja kryesore e takteve është në të thjeshta (që përmbajnë një tezë) dhe të përbëra (që përmbajnë dy ose më shumë teza). Taktet mund të ndahen edhe në të rregullta (me ndarje të barabartë) dhe takte të parregullta (me ndarje jo të barabartë).

Për përcaktimin e kohëzgjatjes së vlerave të notave brenda një takti, rëndësi kyçe ka njësia matëse që shkruhet menjëherë pas çelësit.

X – numëruesi tregon numrin e pjesëve të taktit

Y – emëruesi tregon vlerën e notës që është marrë si pjesë e taktit.

*Shembulli 1*

$\frac{2}{4}$  dy rrahje brenda një takti  
 $\downarrow$  nota katërshe ka vlerën e një rrahjeje (↓↑)

*Shembulli 2*


$\frac{3}{2}$  tri rrahje brenda një takti  
 $\downarrow$  nota gjysmë ka vlerën e një rrahjeje (↓↑)

*Shembulli 3*

$\frac{7}{8}$  shtatë rrahje brenda një takti  
 $\downarrow$  nota tetëshe ka vlerën e një rrahjeje (↓↑)

**Taktet e thjeshta** janë taktet që kanë dy dhe tri pjesë.

Takti dypjesor ka dy pjesë të taktit, ku pjesa e parë është e theksuar, ndërsa pjesa e dytë është e patheksuar.







## TEORIA E MUZIKËS NËPËRMJET PRAKTIKËS

Takti tripjesor ka tri pjesë të taktit, ku pjesa e parë është e theksuar, ndërsa pjesa e dytë dhe e tretë janë të patheksuara.

ta ta ta ta ta ta  
↓↑ ↑↓ ↓↑ ↓↑

### Mëso më shumë!

Taktet tripjesore kanë tre numërime – i pari është i theksuar, ndërsa dy të tjerat janë të patheksuara. Ky ritëm është baza e valsit, një nga stilet më të njohura dhe më romantike të vallëzimit në historinë e muzikës dhe vallëzimit.

Valsi u shfaq në shekullin XVIII dhe menjëherë u lidh me elegancën dhe hijeshinë. Ritmi në 3/4 i udhëheq valltarët në lëvizje të buta dhe të rrumbullakëta, ku goditja e parë gjithmonë thekson fillimin e çdo hapi.

### Aktivitet:

#### 1. Dëgjojmë vals

- Dëgjo me vëmendje “Valsin nr. 2” nga Dimitrij Shostakoviç!



- Identifiko taktin tripjesor (3/4): një-dy-tre, një-dy-tre...
- Trokit mbi bankë ose duartrokit: goditja e parë le të jetë më e fortë (e theksuar), ndërsa dy të tjerat më të dobëta (të patheksuara).
- Mund të bësh edhe lëvizje të vogla me trupin ose me duart, sikur të vallëzosh vals.
- Diskutoni në klasë:
  - Si është atmosfera e muzikës? E gëzuar, nostalgjike apo festive?
  - Si ndjehesh përderisa e dëgjon valsin?
  - A mund të imagjinosh vallëzim që i përshtatet këtij ritmi?



**Taktet e përbëra** janë ato takte që formohen nga bashkimi i takteve të thjeshta. Ato kanë dy ose më shumë pjesë të theksuara të taktit (teza).

Taktet e përbëra janë taktet me katër, pesë, gjashtë, shtatë dhe deri në dymbëdhjetë pjesë.

Takti katërpjesor përbëhet nga dy takte dypjesore. Ka dy teza dhe dy arza. Theksi i parë është më i fortë se i dyti dhe shkruhet me simbolin = :

4/4

ta ta ta ta ta ta ta ta

↕ ↕ ↕ ↕ ↕ ↕ ↕ ↕

### Mëso më shumë!

Taktet dypjesor dhe katërpjesor krijojnë një ritëm të rregullt, energjik dhe të përshtatshëm të të ecurit, prandaj edhe më së shumti përdoren në marshe.

Marshi, si një zhanër muzikor, bazohet pikërisht në këto lloj taktesh, që i përshtatet ritmit natyror të ecjes. Kjo e bën atë të përsosur për qëllime ushtarake dhe paradash.

“Marshi Radeckit”, vepra e famshme e Johan Shtraus të vjetrit, është një nga marshet më të njohura në botë. Ky lloj i kompozimit muzikor krijon ndjenjën e lëvizjes, fuqisë dhe organizimit.

### Aktivitet:

#### 1. Dëgjo “Marshin e Radeckit” dhe ndjeje ritmin!

- Përderisa e dëgjon kompozimin, përpiqu ta ndjekësh ritmin me duar, me këmbë ose me lëvizje të vogla të trupit.





**Taktet e parregullta (jo të barabarta) 5/8, 7/8, 9/8** janë takte të përbëra që përmbajnë grupe ritmike të kombinuara dhe të pabarabarta.

**Takti i 5/8** është takt i parregullt që përbëhet nga pesë pjesë të taktit të cilat kombinohen si 2+3 ose 3+2 sipas së cilës do të përcaktohet edhe taktimi i tij.

Shembull ilustrativ i taktimit në taktin e 5/8 – dora më e madhe tregon tezën, ndërsa dora më e vogël tregon arzën.

2+3

2+3

**Aktivitete:**

**1. Takto në taktin e 5/8!**

2+3

3+2


**2. Shkruaj ushtrime në taktin e 5/8 duke përdorur aplikacion për shkrimin e notave!**




**Takti i 7/8** është takt i parregullt që përbëhet nga shtatë pjesë. Ai mund të përbëhet nga dy takte dypjesore dhe një takt tripjesor me këto kombinime: 2+2+3, 2+3+2, 3+2+2.

Ky takt është tipik për folklorin muzikor maqedonas, por haset edhe në folklorin muzikor shqiptar dhe të komuniteteve tjera.


2+2+3



2+3+2



3+2+2



### Aktivitete:

1. Shkruaj ushtrime në taktin e 7/8 në aplikacion për shkrimin e notave.
2. Duartrokite sipas ritmit të kompozimit (7/8 Beat songs 2+2+3)





**Takti i 9/8** – është takt që përbëhet nga nëntë pjesë. Ai mund të përbëhet nga tre takte tripjesore (me ndarje të rregullt) 3+3+3 ose nga modele të tjera jo të rregullta si 2+3+2+2, 2+2+3+2, 2+2+2+3, 3+2+2+2.

3+3+3

8

2+3+2+2

8

2+2+3+2

8

2+2+2+3

8

3+2+2+2

8



### Mëso më shumë!

Taktet e parregullta janë karakteristike për muzikën tradicionale të Ballkanit dhe Lindjes së Mesme.


Edhe pse për traditën muzikore perëndimore ato duken të pazakonta ose “jo të rregullta”, në këto rajone taktet e parregullta janë pjesë e natyrshme e shprehjes muzikore dhe shpesh mësohen që në moshë të hershme, përmes këndimit, vallëzimit dhe lëvizjes.

### Aktivitete:

1. Shkruaj ushtrime ritmike në taktin e 9/8 në ndonjë aplikacion për shënimin e notave në të gjitha modelet ritmike!
2. Dëgjo këtë kompozim duke duartrokatur sipas ritmit dhe zbulo sipas cilit model ritmik të taktit të 9/8 është e interpretuar!



3. Cilat nga këta modele ritmike janë takte të rregullta dhe cilat takte të parregullta?








## APLIKACIONE PËR SHKRIMIN E NOTAVE

Në arsimimin modern muzikor, përdorimi i programeve kompjuterike për shënimin e notave përbën një pjesë të rëndësishme të zhvillimit të shkrimit muzikor dhe kreativitetit. Me ndihmën e programeve (aplikacioneve) për shënimin muzikor, mund të mësohet në mënyrë praktike si shkruhen dhe analizohen notat, intervalet, akordet dhe elementet tjera muzikore. Po ashtu, mësohet se si të futet, redaktohet dhe printohet teksti i notave në mënyrë profesionale.



### Mëso më shumë!

Në kompjuter, duke përdorur programet e specializuara, mund të kompozosh si një kompozitor i vërtetë!

### Aktivitete:

1. Në programin për shënimin e notave, shkruaj intervale melodike dhe harmonike!
2. Me ndihmën e mësimitdhënësit ose vetë, përdor programin për shënimin e notave dhe shkruaj të gjitha shkallët e mësuara dur, me parashenja të sakta dhe renditje të saktë të tingujve!
3. Shkruaj të gjitha shkallët e mësuara mol në programin për shënimin e notave!

# 3 ● INTERPRETIMI MUZIKOR DHE SHPREHJA KREATIVE

## **PËRMBAJTJE:**

- Interpretimi vokal dhe instrumental
- Sinkretizmi – muzika dhe artet tjera


## Koncepte kyçe:

- Interpretim vokal solo, interpretim vokal në grup dhe kolektiv, kor, orkestër, bend, këngë artistike, këngë pop, këngë rok, këngë popullore
- fragment, sekuencë, koreografi, skenografi, dramatizim

## Do të mësosh:

- të këndosh këngë, të luash ushtrime dhe shembuj nga vepra muzikore të ndryshme sipas zhanrit, karakterit, përmbajtjes dhe nivelit, solo ose në grup, një-zërësh dhe shumë-zërësh, sipas dëgjimit dhe sipas notacionit;
- të këndosh/luash në solo, në grup ose kolektiv me interpretim vokal/instrumental;
- të shprehesh në mënyrë kreative përmes krijimit të fragmenteve të shkurtra muzikore, projekteve digjitale dhe të tjera, me ndihmën e TIK-ut dhe IA-së.

# INTERPRETIMI VOKAL DHE LUAJTJA NË INSTRUMENTE



*Lloje të ndryshme interpretimi*

## Interpretimi vokal

Interpretimi vokal është interpretim muzikor me anë të zërit njerëzor, pra me anë të këndimit. Për të kënduar bukur dhe saktë, duhet të respektohen disa rregulla dhe teknika të rëndësishme:

- Frymëmarrja e rregullt – ajri merret thellë përmes hundës dhe kontrollohet me diafragmë. Kjo na ndihmon të këndojmë më gjatë dhe pa lodhje.
- Dikson i qartë – çdo fjalë dhe rrokje duhet të shqiptohet qartë, që dëgjuesit ta kuptojnë tekstin.
- Intonacion i mirë – notat duhet të këndohen saktë, pa gabime intonative.
- Ekuilibër në zë – të mos bërtasim e as të pëshpëritim, por të gjejmë tonin natyror dhe të rehatshëm të zërit tonë.
- Shprehje emocionale – me ngjyrën e zërit dhe shprehjen e fytyrës të përcjellim emocionin e këngës (gëzim, trishtim, dashuri...).
- Qëndrim i duhur i trupit – trupi duhet të jetë i drejtë dhe i relaksuar – kjo ndihmon për frymëmarrje më të mirë dhe kontroll të zërit.
- Ushtrime të rregullta – si çdo aftësi tjetër, edhe këndimi kërkon ushtrim të vazhdueshëm për t'u përmirësuar.



Luçiano Pavaroti

Llojet e interpretimit vokal:

- **Interpretim vokal solo** – kur këngëtari këndon vetëm, pa zëra të tjerë.
- **Interpretim vokal kolektiv** – kur disa këngëtarë këndojnë së bashku si grup.

**Kënga** është një formë muzikore e përbërë nga melodia dhe teksti.

**Kënga solo** është një kompozim muzikor që interpretohet nga një zë (këngëtar) dhe mund të shoqërohet nga një instrument (për shembull piano ose kitarë) apo nga orkestra.

**Kënga artistike** është një kompozim i shkruar për zë dhe shoqërim instrumental, zakonisht me piano. Ajo krijohet nga kompozitori mbi bazën e një teksti poetik.

**Kënga popullore** është një krijim që rrjedh nga autor i panjohur, është pranuar nga populli dhe është transmetuar brez pas brezi përmes traditës gojore. Melodia e këngës popullore është zakonisht e thjeshtë dhe interpretohet me ose pa shoqërim nga instrumente tradicionale popullore.

## Mëso më shumë!

“O sole mio” (*O dielli im*) është një nga këngët më të njohura italiane, e krijuar në vitin 1898. Teksti është shkruar në dialektin napolitan nga Xhovani Kapuro, ndërsa muzika është kompozuar nga Eduardo di Kapua dhe Alfredo Mazuçi. Kënga mban titullin “O, dielli im”, që simbolizon dashurinë dhe dritën që një person mund të sjellë në jetën e një tjetri. Është interesante që kjo këngë jo vetëm që u bë e njohur në Itali, por edhe në mbarë botën. “O, dielli im” është njëra nga standardet klasike më të interpretuara në muzikë. Ajo është interpretuar nga shumë artistë dhe grupe, përfshirë edhe figura të famshme si Plaçido Domingo dhe Luis Armstrong.



Botimi i parë i partiturës “O dielli im”

## Aktivitet:

1. Këndim me nota i këngës “O, dielli im” (*O sole mio*)– këngë napolitane





## Rrjedha e aktivitetit:





- Dëgjo këngën me vëmendje dy herë – herën e parë pa ndërprerje dhe herën e dytë duke u fokusuar në shqiptimin e fjalëve dhe melodinë!
- Lexo tekstin e këngës duke ndjekur ritmin e muzikës!
- Mëso melodinë duke lexuar dhe kënduar notat. Puno për intonacion të saktë!
- Pasi të zotërohet linja melodike, bashkangjite tekstin duke kënduar vargjet në përputhje me ritmin dhe melodinë!
- Kushtoi vëmendje tempos dhe dinamikës së interpretimit!
- Pas zotërimit të këngës, interpreto melodinë individualisht. Në pjesën e refrenit, përfshihuni të gjithë, duke krijuar një interpretim kolektiv me tingëllimë të plotë dhe bashkëpunim në interpretim!

'O sole mio  
Che bella cosa na jurnata 'e sole  
N'aria serena doppo na tempesta!  
Pe' ll'aria fresca pare già na festa  
Che bella cosa na jurnata 'e sole  
Ma n'atu sole cchiù bello, oi ne'  
'O sole mio sta nfronte a te!  
'O sole, 'o sole mio  
Sta nfronte a te, sta nfronte a te!  
Quanno fa notte e 'o sole se ne scenne  
Me vene quase 'na malincunia  
Sotto 'a fenesta toia restarria  
Quanno fa notte e 'o sole se ne scenne  
Ma n'atu sole cchiù bello, oi ne'  
'O sole mio sta nfronte a te!  
'O sole, 'o sole mio  
Sta nfronte a te, sta nfronte a te!

*Teksti i këngës "O dielli im"  
në gjuhën napolitane*

## 'O sole mio Këngë napolitane

Andantino



**Kënga pop** është kompozim muzikor që i përket zhanrit të muzikës pop, (termi muzikë pop është shkurtesë nga “muzikë e popullarizuar”). Ky zhanër është i destinuar për një audiencë të gjerë dhe shpesh ka melodi të lehta për t’u mbajtur mend, strukturë të qartë, refrene të përsëritura dhe tekste që flasin për dashurinë, emocionet ose jetën e përditshme.

Muzika pop si zhanër ka filluar të formohet në fund të viteve 1950 në SHBA dhe në Britaninë e Madhe. Ajo u shfaq si një evoluim i rokënrolit, por me tingull më të butë dhe tekste më të thjeshta, me qëllim që të tërheqë më shumë publikun e gjerë, veçanërisht të rinjtë.

### SQARIM MBI STILET MUZIKORE:

Elvis Prisli (*Elvis Presley*), Bitëlls (*The Beatles*) dhe artistë të tjerë të njohur ndërkombëtarisht kanë krijuar vepra muzikore në stile të ndryshme. Disa nga këngët e tyre janë në stilin e muzikës pop, ndërsa të tjerat i përkasin muzikës rok. Prandaj, i njëjti artist mund të lidhet me disa stile muzikore, në varësi të karakterit të këngës dhe shpesh herë konsiderohet si themelues i shumë stileve dhe zhanreve muzikore!

### Mëso më shumë!

1. Kënga që shpesh konsiderohet si kënga e parë e vërtetë pop është “Rock Around the Clock” nga “Bill Haley & His Comets” (1954), megjithëse muzika pop si zhanër i veçantë fillon të formohet pak më vonë, me interpretues si Elvis Prisli (*Elvis Presley*), Bitëlls (*The Beatles*), Suprems (*The Supremes*) dhe të tjerë.

2. Këngëtari më i njohur në historinë e muzikës pop është Majkëll Xhekson (*Michael Jackson*) – i njohur si “Mbreti i Popit” (*King of Pop*). Muzika e tij ka bashkuar elemente të pop-it, soul-it, rock-ut dhe funk-ut në një stil unik.

Albumi Triler (*Thriller*) (1982) është albumi më i shitur i të gjitha kohërave, me mbi 70 milionë kopje të shitura.

*Performanca ikonike dhe inovacione* – përfshirë edhe “moonwalk”-un legjendar. Në paraqitjen e parë televizive me “Billie Jean”, publiku mbeti i habitur kur ai e interpretoi për herë të parë “moonwalk”-un – që u bë menjëherë një fenomen kulturor.

*Videoklipe me ndikim të madh* – ai ishte ndër artistët e parë që e shndërroi videoklipin muzikor në një formë arti (p.sh. videoklipi i Thriller-it).

*Ndikimi* – ai ka frymëzuar gjenerata artistësh anembanë botës dhe muzika pop nuk do të ishte njësoj pa të.



Majkëll Xhekson

## Aktivitet:

### 1. Perkusion trupor me ritmin e këngës “They Don’t Care About Us” nga Michael Jackson.

Sqarim:

Perkusion trupor do të thotë të përdorim trupin tonë si instrument – për shembull:

- duartrokitje,
- goditje me shuplaka në kofshë,
- trokitje me këmbë,
- rrahje me duar në gjoks, etj.



Rrjedha e aktivitetit:

- Dëgjoni me kujdes këngën dhe përpiquni të dalloni ritmin e saj!
- Më poshtë ndodhet një ushtrim me dy linja ritmike të ndryshme, të përbëra nga figura që përputhen me ritmin e kompozimit.

- Vazhdo me të njëjtin model deri në fund të këngës!
- Organizohuni në dy grupe të ndara!

Çdo grup ushtron një model ritmik të ndryshëm – grupi i parë mëson modelin e parë, ndërsa grupi i dytë punon me modelin e dytë.

- Pasi të ndjeheni të sigurt në interpretimin e roleve tuaja ritmike, të dy grupet bashkoni linjat ritmike dhe shoqëroni këngën me modelin ritmik të krijuar.

**Kënga rok** është kompozim muzikor që i përket zhanrit të muzikës rok – një nga stilet më me ndikim dhe më të njohur të shekullit XX dhe XXI.

Muzika rok u shfaq në SHBA në vitet 1950, si vazhdimësi e bluzit, xhazit dhe muzikës kantri. Fillimisht u quajt rokenrol dhe ishte e destinuar për publikun e ri. Një nga yjet e parë të mëdhenj të rokut ishte Elvis Prisli.

Në vitet 1960 dhe 70, roku u zhvillua në disa stile: rok klasik, rok psikodelik, hard rok, pank rok dhe shumë të tjera. Grupe të njohura si “Bitëlls” (*The Beatles*), “Rollingstouns” (*The Rolling Stones*), “Led Cepelin” (*Led Zeppelin*) dhe “Pink Flojd” (*Pink Floyd*) e bënë muzikën rok të njohur në të gjithë botën.

Këngët rok shpesh flasin për dashurinë dhe emocionet, për lirinë dhe rebelimin, për problemet shoqërore dhe padrejtësitë, për jetën e të rinjve dhe ndjenjat e tyre.

Ndonjëherë tekstet janë personale, e ndonjëherë kritike ndaj shoqërisë.

Një grup tipik rok përfshin:

- Kitarë elektrike – instrument kryesor melodik dhe solo instrument
- Kitarë bas – jep bazën ritmike dhe tingëlluese
- Instrumente me të goditur – mbajnë bazën ritmike
- Tastierë ose piano (nganjëherë)
- Këngëtar/vokal – udhëheq melodinë dhe tekstin
- Disa grupe shtojnë edhe instrumente tjera, si harmonikë, violinë, sintetizatorë apo edhe elemente orkestrale, në varësi të stilit.

### Mëso më shumë!

Disa këngë, edhe pse janë shumë të vjetra, mbeten aq të bukura dhe domethënëse, sa që edhe pas shumë vitesh ripunohen nga grupe apo artistë të rinj. Një këngë e tillë është “Knockin’ on Heaven’s Door”.

Këtë këngë për herë të parë e shkroi dhe e interpretoi Bob Dylan në vitin 1973, si pjesë e muzikës për filmin “Pat Garrett and Billy the Kid”. Kënga ka një melodi të thjeshtë, por shumë të fuqishme dhe flet për momentet kur njeriu ndodhet përpara një kthese të madhe në jetë.

Ironia e kësaj kënge është se versioni i Dylan-it është i lënë disi në hije për shkak të përpunimeve të shumta ndër vite.



Bob Dylan



Më vonë, këngën e ripunoi edhe rok grupi i njohur “Guns N’ Roses”, i cili i dha një tingull më energjik rok dhe e bëri sërish të njohur te gjenerata e re e dëgjuesve. Kështu, “Knockin’ on Heaven’s Door” u bë një këngë e pa kohë, që i lidh gjeneratat e ndryshme përmes muzikës.



Rok grupi “Guns N’ Roses”

### Aktivitet:

#### 1. Këndojmë me ritëm sipas dëgjimit – “We Will Rock You” nga rok grupi “Queen” (Queen).

“We Will Rock You” është një nga këngët më të njohura të grupit “Queen” (me tekst dhe muzikë nga kitaristi Brian May), e publikuar në vitin 1977 në albumin “News of the World”. Kënga është veçanërisht e njohur për ritmin e saj të thjeshtë, por të fuqishëm, i cili përbëhet nga trokitje me duar dhe me këmbë, që është shumë e lehtë për t’u dalluar.

Teksti i këngës është një himn i fuqishëm për vetëbesim, fitore dhe rebelim. Përmbajtja fokusohet te një i ri që përballet me jetën, me të gjitha vështirësitë dhe pengesat që i dalin përpara. Por, pavarësisht nga të gjitha këto vështirësi, ai është i vendosur të arrijë suksesin e vet.

Në këngë flitet për zgjimin e guximit, forcës së brendshme dhe besimit në fitore. Logjika është se kushdo që e dëgjon këtë këngë, do të ndiejë frymëzim dhe motivim për të arritur qëllimet e veta, pavarësisht pengesave që mund të hasë në rrugën e jetës.

*„We Will Rock You“*

*(Bryan May - Queen)*

*Buddy, you’re a boy, make a big noise*

*Playing in the street, gonna be a big man someday*

*You got mud on your face, you big disgrace*

*Kicking your can all over the place, singin’*

*We will, we will rock you*

*We will, we will rock you*



Rrjedha e aktivitetit:

- Dëgjoni këngën “We Will Rock You” nga rok grupi “Queen”, për t’u njohur me melodinë dhe tekstin!



- Lexoni tekstin e këngës duke ndjekur ritmin e muzikës!
- Mësoni melodinë!
- Bashkoni tekstin me melodinë!
- Shoqërim ritmik – Vetë krijoni modele ritmike duke përdorur trupin tuaj, si p.sh. të rrahurat me duar, goditjet me këmbë apo duartrokitjet, që ndjekin ritmin e këngës.

## Interpretim kolektiv vokal dhe instrumental

**Interpretimi kolektiv** është kur një grup interpretuesish (këngëtarë, instrumentistë) muzikojnë së bashku, duke krijuar një shprehje të përbashkët muzikore.



*Interpretim kolektiv*

**Interpretimi kolektiv vokal** është kur disa këngëtarë këndojnë së bashku, si grup.

**Interpretimi instrumental** paraqet interpretimin muzikor të një vepre me një ose më shumë instrumente muzikore, pa këndim. Muzikanti e përdor instrumentin si mjet shprehës. Interpretimi instrumental mund të jetë individual ose grupor (kolektiv).

**Interpretimi vokalo-instrumental** paraqet interpretimin e një vepre muzikore ku marrin pjesë njëkohësisht zëri/zërat dhe instrumenti/instrumentet.



*Kor*

**Kor** është një grup këngëtarësh që së bashku interpretojnë vepra muzikore, nën drejtimin e dirigjentit. Anëtarët e korit këndojnë linja të ndryshme melodike nëpërmjet vokalit, duke krijuar një harmoni ndërmjet tyre dhe duke u koordinuar për të arritur një efekt të përsosur tingullor. Kori mund të formohet sipas gjinisë (femëror, mashkullor dhe i përzier) dhe moshës së interpretuesve (kor fëmijësh, kor pensionistësh etj.). Ai përbëhet nga disa zëra – sipas shtrirjes (p.sh. soprano, alt, tenor dhe bas) – dhe interpreton muzikë në stile të ndryshme, nga ajo klasike deri te ajo bashkëkohore.

**Orkestra** është një grup i madh instrumentistësh që luajnë së bashku, secili në instrumentin e tij. Orkestra mund të interpretojë muzikë klasike, muzikë filmi dhe lloje të tjera kompozimesh. Ekzistojnë disa lloje orkestrash, varësisht nga qëllimi dhe numri i interpretuesve. Një orkestër standarde zakonisht ka katër grupe instrumentesh: instrumente me tela, instrumente frymorë prej druri, frymorë prej metali dhe instrumente me të goditur. Orkestrën e udhëheq dirigjenti, i cili me lëvizjet e duarve dhe shkopin, sinjalizon se kur dhe si duhet të interpretojnë muzikantët.



*Orkestër*

**Bendi** - është një formacion më i vogël muzikor që interpreton muzikë në zhanre si pop, rok, xhaz apo etno. Çdo bend mund të përbëhet nga instrumentistë të ndryshëm, ndërsa një bend tipik zakonisht ka kitarist, bas kitarist, baterist, ndonjëherë edhe tastierist dhe vokalist.



*Kitarë akustike*



*Kitarë elektrike*



*Bateri*



*Sintetizatorë*

**Aktivitet:****1. Interpretimi i pjesës “Oda e Gëzimit” (me nota)**

Rrjedha e aktivitetit:

- Dëgjoni kompozimin “Oda e Gëzimit” me qëllim që të fitoni një përshtypje të përgjithshme për karakterin, tempon dhe dinamikën e pjesës!
- Lexoni tekstin e këngës me diksion të qartë, duke iu kushtuar vëmendje shqiptimit, theksit dhe strukturës ritmike të fjalëve!
- Me ndihmën e mësimitdhënësit, mësoni melodinë përmes leximit të partiturës dhe këndimit të notave! Të praktikohet frazimi dhe intonacioni.
- Pas zotërimit të melodisë, kombinoni atë me tekstin, duke i kënduar vargjet në përputhje me vijën melodike.
- Analizoni dhe praktikoni interpretimin me tempo dhe dinamikë të përshtatshme, me qëllim që të arrini ekspresionin muzikor!
- Interpretoni këngën së bashku si grup koral, duke iu kushtuar vëmendje sinkronizimit, intonacionit dhe të shprehurit muzikor të përbashkët.



## Oda e gëzimit

### Ludvig van Bethoven

Moderato (mesatare)



G'zim jep - ni në zem - rat tu - a, drit' hyj - no - re zjarr i shenjt',  
Të gjith' je - mi një fa - mi - lje, nën qie - llin që ne na mbron,

lidh - ni bo - tën me krah t'pa - qes, shpir - trat bash - ko - hen për - jet'.  
le të fla - sin ze - mrat to - na dhe me da - shu - ri t'ndri - çojm'.

Ai që ka një mik pran' ve - tes, le të ndje - je lum - tu - ri.  
Kën - ga jon' të na ba - shko - je, n'har - mo - ni dhe u - ni - tet.

Të v'lla - z'rua - ar të gjith' njer' - zit nën dri - tën e da - shu - ris'.  
Në gë - zim dhe shpre - sa t're - ja, të ba - shku - ar për një jet'.



## SINKRETIZMI NË ART



Sinkretizmi do të thotë bashkim i arteve të ndryshme (muzikë, lëvizje, fjalë, pikturë) në një vepër të përbashkët artistike.

Elementet artistike që mund të kombinohen dhe përmes të cilëve mund të krijohet një vepër artistike janë:

- *Muzika* – këndim, interpretim në instrumente, mbështetje ritmike.
- *Koreografia* – vallëzim ose lëvizje skenike që e shprehin muzikën.

- *Narratori* – person që rrëfen ose lexon tekstin për të udhëhequr tregimin.
- *Dramatizimi* – shprehje skenike përmes të folurit, lëvizjes dhe emocioneve.
- *Skenografia* – pamja dhe rregullimi i skenës (sfondi, rekuizitat).
- *Kostumografia* – veshjet dhe stili vizual i interpretuesve.
- *Ndriçimi dhe efektet* – krijimi i atmosferës dhe theksimi i momenteve.
- *Shprehja pamore* – maska, simbole, rekuizita, detaje artistike.

Të gjithë këta elemente lidhen në një vepër të vetme artistike për të përcjellë emocione, mesazhe dhe një përjetim vizualo-muzikor.

### Aktivitet:

#### 1. Krijoni një lojë muzikore (koreografi, skenografi, këndim, instrumente, dramatizim) sipas shembullit të filmit “Mjuzikëll i shkollës së mesme” (*High School Musical*).



- Ndjekja e një fragmenti nga filmi “Mjuzikëll i shkollës së mesme” (*High School Musical*)!
- Krijoni momentin tënd sikur në filmin “Mjuzikëll i shkollës së mesme” (*High School Musical*)!
- Si do ta paraqisnit fragmentin e zgjedhur si një dramatizim muzikor përmes:
  - Këndimit (solo dhe në grup),
  - Luajtjes së intervaleve të thjeshta në tastierë (me ndihmën e mësimdhënësit),
  - Mbështetjes ritmike me duar apo me instrumente ritmike,
  - Koreografisë (lëvizje në skenë),
  - Kostumografisë (veshja),
  - Skenografisë (rregullimi i skenës).


Përshkruaj ose vizato si do të duket shfaqja! Mund ta paraqesësh përmes një skice, teksti, plani apo një prezantimi të shkurtër.

Së bashku me grupin, nën udhëheqjen e mësimdhënësit, përgatitni dhe realizoni dramatizimin muzikor për interpretim para klasës ose në një aktivitet shkollor.

# 4. TRASHËGIMIA KULTURORE MUZIKORE

## PËRMBAJTJE:

- Kënga në traditën popullore maqedonase dhe në traditën e popujve që jetojnë në R.M.V.
- Vallëzimet dhe vallet popullore në traditën popullore
- Instrumentet në traditën popullore
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë muzikore popullore




## Koncepte kyçe:

- këndim tradicional - këndim me fyt; njëzërëshi; dyzërëshi: këndimi me iso (bordun)/ këndim me zë të mbajtur; dyzërëshi me tercë të sipërme ose kuintë; trezërëshi; ornamentet; klasifikimi: këngë kalendarike dhe këngë jokalendarike/sipas qëllimit - këngë kuvendare, këngë të odave, këngë vallesh
- muzikë folklorike, vallëzim, valle popullore, kërcim, hapa, rrotullim, figura, shoqërim instrumental
- ndarja sipas pamjes dhe tingëllimës: instrumente me tela, instrumente frymore, instrumente me të goditur; ndarja sipas origjinës: instrumente të fshatit/popullore dhe instrumente të qytetit/të prodhuara në fabrika

## Do të mësosh:


- t'i kategorizosh këngët, vallëzimet, vallet popullore dhe instrumentet në traditën popullore;
- t'i shpjegosh mënyrat e ndryshme të këndimit të këngëve popullore, mjetet shprehëse në vallet popullore dhe klasifikimin e instrumenteve popullore sipas pamjes dhe tingëllimës;
- ta kuptosh rëndësinë dhe mënyrat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së trashëgimisë kulturore/muzikore;
- të këndosh/luash shembuj nga këngët, vallëzimet dhe vallet e traditës popullore, duke aplikuar elementet shprehëse muzikore të tyre.







# KËNGA NË TRADITËN POPULLORE MAQEDONASE DHE NË TRADITËN E POPUJVE QË JETOJNË NË RMV



## Këndimi tradicional



*Këndim tradicional grupor*



*Interpretim vokalo-instrumental*

Jeta e popullit gjithmonë ka qenë thellësisht e lidhur me traditën. Përmes zakoneve, besimeve, muzikës popullore, valleve, kostumeve dhe zejeve, nga brezi në brez, janë transmetuar vlerat, përvojat dhe identiteti. Tradita popullore përfaqëson një dëshmi të gjallë për pasurinë shpirtërore të një populli dhe shërben si një lidhje e fortë mes së kaluarës dhe së tashmes. Ajo jo vetëm që pasqyron jetën e përditshme, por edhe ruan kujtesën kolektive dhe identitetin kulturor.

Trashëgimia kulturore muzikore, e transmetuar brez pas brezi si një vlerë jo materiale për çdo popull, mbështetet mbi muzikën popullore – këngët popullore, vallet dhe instrumentet. Që nga fillimi kur muzika ishte ekskluzivisht folklorike, e deri te zhvillimi i saj i plotë në një art profesional, ajo përmban në vete tipare që lidhen ngushtë me truallin ku ka lindur.

Sipas mënyrës së interpretimit, në ndërtimin e muzikës folklorike dallohen katër grupe:

- *praktika vokale (njëzërëshi dhe shumëzërëshi);*
- *instrumentet muzikore (me ndërtim, formë dhe përdorim të ndryshëm);*
- *forma të interpretimit vokalo-instrumental;*
- *valle popullore me këndim ose me përcjellje instrumentale.*

### Mëso më shumë!

Në konferencën e *Këshillit ndërkombëtar për muzikën popullore* që u mbajt në Sao Paulo të Brazilit në vitin 1954, u formulua përkufizimi i folklorit muzikor dhe ai është si vijon: “Muzika folklorike është produkt i traditës muzikore që është zhvilluar nëpërmjet procesit të traditës gojore.”

Faktorët që ndikojnë në formimin e traditës folklorike janë kontinuiteti, variacioni dhe selektimi.



**Kënga popullore** është një krijim muzikor gojor, i krijuar dhe i transmetuar nga brezi në brez. Ajo është shprehje e shpirtit, zakoneve, historisë dhe jetës së përditshme të një populli. Këndohet në raste të ndryshme (në dasma, festa, gjatë punës si korrja, vjelja, kositja, në raste të trishtuara etj.) dhe përbën një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore.

Kënga popullore është një nga pasuritë më të rëndësishme të kulturës muzikore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ajo nuk është vetëm një shprehje artistike, por edhe mënyrë jetese, rit dhe komunikim mes njerëzve.

Populli, përmes këngës, ka shprehur të gjitha ngjarjet e rëndësishme në jetën individuale dhe kolektive. Këngët mund të klasifikohen sipas **periudhës** kur janë kënduar dhe **qëllimit** për të cilin këndohen. Kështu, ndarja e përgjithshme sipas periudhës është:

- **Këngë kalendarike**, të lidhura me data të caktuara dhe stinë të vitit, të grupuara në këngë të ciklit dimëror, pranveror, veror dhe vjeshtor.
- **Këngë jokalendarike**, të cilat këndohen gjatë gjithë vitit dhe lidhen me momentet më të rëndësishme të jetës së njeriut – lindjen, dasmën dhe vdekjen.

Si shembuj të këngëve kalendarike janë këngët e lidhura me festa fetare ose me aktivitetet e punës në periudha të caktuara të vitit, ndërsa si shembuj të këngëve jokalendarike janë ato të dasmave, të bagëtive, vajeve, ninullave etj.

Sipas qëllimit, këngët mund të grupohen në: këngë të dashurisë, të dasmave, të lojërave, humoristike, të gurbetit, baritore, atdhetare etj.

Sipas periudhës së krijimit dhe stilit të interpretimit dallohen këngët nga tradita e vjetër fshatare, këngët nga tradita e re fshatare dhe këngët nga tradita qytetare. Të gjitha, qoftë fshatare apo qytetare, kanë karakteristika të njohura stilistike që dalin nga mënyra e të kënduarit. Edhe pse të shumta dhe të llojllojshme, këngët, qofshin të kënduara në kohë të caktuara ose për raste të ndryshme gjatë vitit, janë në thelb rituale apo zakonore, dhe shpesh janë të shoqëruara me valle.

Meloditë e këtyre këngëve dallojnë, por kanë edhe tipare të përbashkëta si: shtrirje të vogël melodike, ritëm të njëtrajtshëm, lëvizje të thjeshtë melodike, intonim jo të qëndrueshëm dhe tone recituese.

Në **traditën maqedonase** karakteristike janë të kënduarit **njëzanor** dhe **dyzanor** – sidomos mënyrat e këndimit me zë të mbajtur. Dyzërëshi zakonisht arrihet me **tercë** të sipërme ose **kuintë**, ndërsa në disa rajone haset edhe **këndimi në tre zëra**. Këndimi shpesh përfshin **ornamente** (zbukurime) dhe një mënyrë specifike të intonimit.

Në **traditën shqiptare** janë të pranishme të **kënduarit me fyt**, të kënduarit me ritëm karakteristik, shumëzërëshi dhe heterofonia. Veçanërisht të rëndësishme janë **këngët epike**, të kënduara nga gjinia mashkullore dhe **këngët lirike**, të kënduara më shumë nga gjinia femërore. Këto këngë shpesh shoqërohen me def, çifteli dhe lahutë.

Muzika **popullore turke** është e pasur me **ornamente melizmatike**, shkallë modale (makame) dhe shpesh interpretohet me instrumente si **saz**, **kanun** apo **kaval**. Këndimi mund të jetë solo apo në grup, me një emocionalitet të theksuar.

**Tradita muzikore rome** dallohet për ritmikën e fortë, virtuoze dhe meloditë e lira. Ajo shpesh përmban ndikime nga elementët muzikorë ballkanikë, orientalë dhe perëndimorë, dhe këngët interpretohen me shumë ekspresivitet.



**Te vllahët**, këndimi është gjithashtu melizmatik, me ornamente të pasura dhe një vijë melodike karakteristike. Shpesh këndohet në zëra të përzier (meshkuj, femra), dhe këngët janë pjesë e jetës së përditshme dhe ritualeve.

Gjithashtu, **muzika tradicionale e komuniteteve boshnjake, serbe**, dhe të tjera kontribuon në pasurinë e traditës vokale me stile lokale specifike, shkallë të ndryshme dhe timbre të veçanta të zërit.

### Mëso më shumë!

A e dini se në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka disa tradita muzikore dhe folklorike që janë të mbrojtura nga UNESCO si trashëgimi kulturore jomateriale?

Në listën e UNESCO-s janë të shënuara këndimi dyzanor i burrave “Glasoečko” nga Pollogu i Poshtëm, si dhe vallja unike “Kopačka” nga Dramçe. Në vitin 2024 edhe gjajda maqedonase zyrtarisht u bë pjesë e hartës kulturore botërore!

Iso-polifonia (këndimi shumëzërësh) përfaqëson një nga elementët më të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore jomateriale të shqiptarëve. Në vitin 2008 është përfshirë në listën e UNESCO-s si një formë unike e këndimit polifonik.

### Aktivitete:

#### 1. Pyetje dhe detyra për përsëritje:

- Shpjego rolin e traditës popullore në ruajtjen e identitetit kulturor të një populli.
- Sipas mënyrës së interpretimit cilat janë katër grupet në ndërtimin e folklorit muzikor?
- Cili është dallimi mes këngëve popullore kalendarike dhe atyre jokalendarike?
- Përmend disa lloje këngësh popullore sipas qëllimit të tyre!
- Cilat janë tiparet muzikore të përbashkëta të këngëve popullore tradicionale?

#### 2. Dëgjojmë këngë popullore

- Zgjidhni një këngë popullore për ta dëgjuar!
- Pas dëgjimit të këngës, diskutoni duke u përgjigjur në këto pyetje:
- Çfarë disponimi nxit kënga?
- Kush këndonte – burrë apo grua, solist apo grup?
- A dëgjuat instrumente?
- Si ishte ritmi – i shpejtë apo i ngadaltë?
- Çfarë karakteristika vokale identifikoni në këngë?
- Për çfarë këndohet në këtë këngë?



# VALLËZIMET DHE VALLET POPULLORE NË TRADITËN POPULLORE



*Interpretime vallesh*

## Muzika folklorike – tradicionale dhe ajo e re autoriale

**Muzika folklorike** përfaqëson shprehjen muzikore më të lashtë dhe më autentike të një populli, e krijuar dhe zhvilluar ndër shekuj, në lidhje të ngushtë me jetën e përditshme, zakonet dhe shpirtëroren e tij. Ajo përbën themelin e traditës muzikore, nga e cila rrjedhin dy format bazë të muzikës popullore: **muzika popullore tradicionale dhe ajo e re autoriale**.

**Muzika popullore tradicionale** është muzikë që transmetohet nga brezi në brez, kryesisht në mënyrë gojore. Ajo është pjesë e trashëgimisë kulturore të popullit dhe lidhet me jetën e përditshme, zakonet, festat, besimet dhe ritualet.

Me kalimin e kohës, krahas muzikës tradicionale, paraqitet edhe muzika popullore e re autoriale, e cila gjithashtu tingëllon si “popullore” dhe është pjesë e muzikës folklorike.

**Muzika popullore e re autoriale** është muzikë e frymëzuar nga tradita dhe muzika folklorike, por e krijuar nga autorë konkretë (kompozitorë dhe tekstshkrues) dhe ka për qëllim interpretimin masiv dhe paraqitjen në media.

Që të mund t’i dallojmë, është e nevojshme t’i lidhim karakteristikat e tyre **muzikore, tekstuale, interpretative dhe sociale**.

## Karakteristikat muzikore

Karakteristikë	Muzika popullore tradicionale	Muzika popullore e re autoriale
<b>Melodia</b>	E thjeshtë, modale, me variacione.	E harmonizuar me formë të qartë.
<b>Ritmi</b>	Takte të parregullta: (5/8, 7/8, 9/8, 11/8).	Takte të rregullta (2/4, 3/4, 4/4) dhe të parregullta.
<b>Instrumentet</b>	Gajde, kavall, mandolinë, timpan, def, zumare.	Kombinim i instrumenteve tradicionale dhe moderne (fizarmonikë, sintetizator, kitarë).
<b>Improvizimi</b>	Shpesh i pranishëm	Rrallë, zakonisht gjithçka është e shkruar dhe kompozuar paraprakisht.
<b>Gjuha dhe të shprehurit</b>	Arkaike, simbolike, me shprehje popullore.	Moderne, shpesh romantike ose nostalgjike.
<b>Temat</b>	Dashuri, vuajtje, familje, rite, trimëri.	Emigrimi, mërgimi, dashuri, gëzim/trishtim, zakone.
<b>Autorësia</b>	Anonime, e transmetuar gojarisht.	Kompozitor, tekstshkrues dhe aranzhues i njohur.

## Karakteristikat interpretuese

Karakteristikë	Muzika popullore tradicionale	Muzika popullore e re autoriale
<b>Ku interpretohet?</b>	Në dasma, korrije, festa, në fshat.	Në skenë, në televizion, në koncerte, në klipe muzikore.
<b>Kush interpreton?</b>	Këngëtarë joprofesionistë, interpretues lokal.	Këngëtarë dhe ansamble profesioniste.
<b>Mënyra e interpretimit</b>	Pa pajisje zërimi, me zë natyral.	Me mikrofon dhe pajisje zërimi (pajisje audio).





## Karakteristikat sociale

Karakteristikë	Muzika popullore tradicionale	Muzika popullore e re autoriale
<b>Përcjellja</b>	Gojarisht, nga brezi në brez.	Përmes medimeve digjitale dhe të internetit – me formate digjitale që mund të ruhen në kompjuterë, telefona, në USB dhe në kartela të memories, përmes radios dhe televizionit.
<b>Funksioni në komunitet</b>	Pjesëmarrje kolektive, identitet dhe ritualitet.	Argëtim, vlerë komerciale.
<b>Roli edukativ</b>	Përcjell vlera, tradita, urtësi.	Lidhet me emocione personale dhe tema bashkëkohore.

Edhe muzika popullore tradicionale, edhe ajo popullore e re autoriale kanë rëndësinë e tyre në kulturë. E para ruan traditën autentike dhe shpirtin e popullit, ndërsa e dyta është një përpjekje për shprehje bashkëkohore e frymëzuar nga krijimtaria popullore. Duke i njohur dallimet e tyre, mësojmë të vlerësojmë evolucionin kulturor dhe rëndësinë e muzikës në shoqëri.

### Mëso më shumë!

A e dini se disa valle dhe melodi popullore janë trashëguar ndër vite pa asnjë notë të shkruar? Muzikantët i mësonin “me vesh”, duke i dëgjuar dhe secili shtonte diçka nga vetja. Prandaj sot mund të dëgjojmë versione të ndryshme të së njëjtës valle apo kënge, në varësi të vendit apo interpretuesit!

Nga ana tjetër, muzika popullore e re autoriale zakonisht ka melodi dhe tekst të shkruar saktësisht dhe shpesh edhe videoklip. Por, edhe përkundër kësaj, ajo përpiqet ta ruajë “tingullin e traditës” përmes instrumenteve, ritmit dhe temave që tingëllojnë të njohura.

## Aktivitete:

### 1. Dëgjojmë fragmente nga muzika popullore tradicionale dhe muzika popullore e re autoriale.

- Muzikë popullore tradicionale:

*këngë popullore maqedonase*

#### **Moj çupëza të Kosturit**

Moj çupëza të Kosturit,  
shtrijeni vallen pak më gjerë,  
të shohim fustanet tuaja.  
I kujt është ai fustan me dallgë,  
që po më bën të dashurohem?  
Që po më bën të dashurohem,  
nga fustani i asaj vajze.



*këngë popullore shqiptare*

#### **Udhës së Shullonit**

Udhës së Shullonit, be djal,  
tuj mi fkat jaranit, be djalo,  
haj, haj, tuj mi fkat jaranit, be djalo.  
O jarani dadës, be djal,  
Sillmi dhent ogradës, be djalo,  
haj, haj, sillmi dhent ogradës, be djalo!  
Sej ato kumbona, be djal,  
mo na naje nana, be djalo,  
haj, haj, mo na naje nana, be djalo.



*këngë popullore turke*

#### **Lugina e Vardarit**

Nga Majadagu fluturojnë rosat,  
Me taka të larta vajzat shndrijnë,  
Zemra e të dashurit tim vajton,  
As të gëzohem dot, as të mashtrohem,  
Në këto anë nuk mund të qëndroj.  
Lugina e Vardarit, lugina e Vardarit,  
Nuk arrita të fitoj para për në shtëpi.





- Muzikë popullore e re autoriale:

*këngë popullore maqedonase*

“Perëndo, perëndo  
diell i ndritshëm”



*këngë popullore shqiptare*

“Poçari”








*këngë popullore rome*

“Xhelem, xhelem”




## 2. Dallo dhe veço duke dëgjuar muzikë!

Duke dëgjuar shembujt muzikorë të mëposhtëm, dalloni cilat këngë janë popullore **tradicionale** dhe cilat janë **popullore të reja autoriale**.

Emri i këngës	Link
“Trëndafili im”	
“Sajzeza”	
“Nedë, e bardha Nedë”	
“Çaje shukarije”	
“Shtëpi kam ndërtuar, Ramizja ime”	

### 3. Organizoni kuiz të vogël muzikor duke u bazuar në pyetjet e mëposhtme:

1. Cili lloj muzike është përcjellë gojarisht nga brezi në brez?
  - a) muzika pop
  - b) muzika popullore tradicionale
  - c) muzika xhaz
2. Cili lloj muzike popullore ka autor të njohur?
  - a) tradicionalja
  - b) muzika popullore e re autoriale
3. Cili instrument haset më shpesh në muzikën popullore tradicionale?
  - a) sintetizatori
  - b) kavalli
  - c) kitara elektrike
4. Si është zakonisht teksti në këngën popullore të re autoriale?
  - a) tërësisht i improvizuar
  - b) i shkruar nga një autor i njohur
5. Cili është roli i muzikës popullore në komunitet?
  - a) vetëm për dëgjim individual
  - b) për shprehje të traditës, bashkësisë dhe emocioneve
  - c) vetëm për trajnim të muzikantëve profesionistë





## Vallëzimet dhe vallet popullore



*Vallëzime dhe valle popullore nga tradita të ndryshme*

Tradita muzikore e një populli nuk përbëhet vetëm nga këngët, por paraqet një tërësi të pasur dhe të larmishme që përfshin edhe vallëzimet, vallet popullore, muzikën instrumentale, format rituale dhe ceremoniale, zhanret lirike dhe epike, si dhe stilet vokale që transmetohen brez pas brezi. Secila prej këtyre formave luan një rol të rëndësishëm në jetën e komunitetit.

**Vallëzimet dhe vallet popullore**, si pjesë e pandashme e trashëgimisë folklorike, paraqesin një shprehje kolektive muzikore dhe lëvizëse, përmes së cilës populli shpreh emocionet, bashkësinë dhe identitetin e tij. Ato interpretohen në raste të ndryshme (festa, punë ose rite) dhe shpesh shoqërohen me instrumente tradicionale dhe ritëm karakteristik që udhëheq natyrën e lëvizjeve. Rajone të ndryshme kanë vallëzimet dhe vallet popullore specifike, që pasqyrojnë individualitetin kulturor lokal.

Ndërmjet vallëzimit dhe valles popullore ekzistojnë dallime edhe ate:

- **vallëzimi** është një koncept më i gjerë dhe i referohet çdo lloj lëvizjeje trupore artistike apo tradicionale që zhvillohet në përputhje me ritmin e muzikës. Vallëzimet mund të jenë solo, dyshe apo në grup, të lira ose të koreografuara, folklorike, klasike (si baleti), bashkëkohore, moderne, latine etj. Vallëzimi mund të ketë karakter artistik, argëtues, ritual ose social;

- **vallja popullore** është një formë specifike e kulturës popullore që karakterizohet nga këto veçori: kryhet në grup (njerëzit kapen për duar, brez ose supe), luhet në rreth, vijë apo gjysmë-rrethi, ka një hap të përcaktuar qartë (model ritmik) që mësohet në mënyrë tradicionale dhe shpesh luhet në festa popullore, dasma dhe ceremoni. Disa valle popullore janë të ngadalta dhe solemne, të tjera – të hareshme dhe të shpejta. Të gjitha vallet popullore janë vallëzime, por jo të gjitha vallëzimet janë valle popullore.

## Stilet dhe llojet e vallëzimeve dhe valleve popullore

Vallëzimet dhe vallet popullore kanë stilin e tyre karakteristik të interpretimit, i cili varet nga: përkatësia rajonale, ritmi, tempi, hapat dhe shprehja emocionale.

Për shembull, në disa rajone, vallet popullore interpretohen me hapa të rëndë dhe dinjitoz (si p.sh. “Teshkoto”), ndërsa në të tjera me lëvizje të shpejta, me kërcime të hareshme (si “Shota” apo “Çoçeku”).

Kur luajmë një valle popullore, është e rëndësishme t’i ndjekim disa lëvizje themelore: **hapat** (lëvizje bazë në drejtime të ndryshme), **kërcimi** (kërcim i vogël lart), **rrotullimi** (lëvizje rrethore e trupit ose e grupit), **figurat** (kombinim hapash që përsëriten).

Vallet popullore mund të ndahen sipas: **formës** (luhet në rreth, rresht, në çifte etj.), **qëllimit** (për dasma, për ceremoni, për punë, për festa), **vendit** (rajonet e ndryshme kanë stile të ndryshme), **mënyrës** së luajtjes (sipas ritmit, tempit dhe lëvizjeve).

Përbërja e shoqërimit instrumental të valleve popullore ndryshon në varësi të rajonit dhe traditës etnike.

Te **vallet popullore maqedonase**, shoqërimi instrumental më i zakonshëm është me: surle, gajde, kavall, daulle, tambura, fyej, ndërsa në kohët e fundit edhe harmonikë, klarinetë, violinë etj.

**Vallet popullore shqiptare** shoqërohen me daulle, dajre, fyej, çifteli, kavall, klarinetë, harmonikë etj.

**Vallet popullore turke** shoqërohen me dajre, daulle, kavall, kanun, klarinetë etj.

**Vallet popullore rome** shoqërohen me surle, daulle, violinë, dajre, klarinetë, harmonikë, saksofon etj.


**Vallet popullore të serbëve dhe boshnjakëve** zakonisht shoqërohen me fyej, daulle, surle, harmonikë, violinë, etj.

**Vllëhët** luajnë valle popullore të shoqëruara me kavall, violinë, harmonikë, kontrabas, klarinetë etj.

### Aktivitete:

#### 1. Dallimi i valleve popullore nga tradita të ndryshme në Maqedoni.

Shembuj:

Valle popullore	Grupi etnik	Link i propozuar
“Teshkoto”	Maqedonas	





“Shota”	Shqiptar	
“Rrugë e re”	Turq	
“Rome”	Rom	
“Boshnjake”	Boshnjak	
“Valle në rreth”	Serb	
“Vllahe”	Vlleh	

- Shikoni videot një nga një dhe më pas përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:  
Si është ritmi (i shpejtë apo i ngadaltë)?  
Si lëvizin valltarët?  
A veshin rroba tradicionale?  
Sa njerëz vallëzojnë dhe në çfarë formacioni?

## 2. Të gjithë të ndryshëm – të gjithë në rreth!

- Duke përdorur hapat bazë nga vallet e shikuara të traditave të ndryshme, përpikuni t’i interpretoni në grup, duke respektuar ritmin dhe formën!

# INSTRUMENTET NË TRADITËN POPULLORE

## Instrumentet popullore dhe ndarja e tyre



*Interpretues të muzikës popullore*

Instrumentet popullore kanë një rëndësi të madhe për kulturën e një populli, sepse ato janë pjesë e **identitetit** të popujve që jetojnë në vendin tonë (maqedonas, shqiptarë, turq, serbë, vlllehë, romë dhe të tjerë). Gjithashtu, ato kontribuojnë në **laramaninë** e muzikës folklorike. Përdoren gjatë **zakoneve**, **festave** dhe **ceremonive** dhe kanë një tingull të veçantë që i bën të dallueshëm. Ata e shoqërojnë këngën, vallëzimin, vallen popullore dhe krijojnë një pamje të veçantë zanore.

Sipas mënyrës së interpretimit dhe tingullit që krijojnë, instrumentet popullore ndahen në tre grupe kryesore:



*Kanuni*



*Çiftelia*



*Tambura*




*Lahuta*

• **Instrumente me tela** (luhet duke e rrëshqitur harkun mbi tela, duke kaluar me gishtat ose me ndonjë mjet tjetër mbi tela ose duke i goditur telat). Në këtë grup bëjnë pjesë: tambura, kemane, kavall, lahuta, çiftelia, kanuni, etj.




- **Instrumente frymore** (luhen duke fryrë në to. Tingulli krijohet përmes vibrimit të ajrit). Në instrumentet frymore bëjnë pjesë: gajdeja, kavalli, zumarja, gërmeta (klarineta), fyelli i dyfishtë, duduku, fyelli etj.



*Zumarja*



*Kavalli*



*Gajde*




*Fyejt*

- **Instrumente me të goditur** (luhen duke i goditur me duar ose me shkopinj. Ato mbajnë ritmin në muzikë). Në këtë grup bëjnë pjesë: daullja, defi, darabuka, etj.



*Darabukë popullore*



*Lodra*



*Darabukë e fabrikuar*



*Defi*

Instrumentet popullore gjithashtu mund të ndahen sipas prejardhjes dhe mënyrës së ndërtimit të tyre:








- **Instrumente popullore** të punuara me dorë, nga materiale natyrore, shpesh janë unike për ndonjë rajon ose fshat, dhe përdoren në folklor dhe muzikë tradicionale. Si shembull mund të përmendim: gajden, zumaren, daullen, kemanen, kavallin etj.

- **Instrumente të fabrikuar** të prodhuara në punëtori ose fabrika, që përdoren më shpesh në ansamble dhe orkestra dhe nganjëherë janë përshtatje të instrumenteve popullore me tingull të përmirësuar. Shembull: tambura (e përkryer), harmonika, klarineta, violina, etj.

**Aktivitet:**

**1. Zbulo zërin e traditës!**

- Përmes dëgjimit të shembujve të dhënë, tregoni se cilët instrumente përdoren në secilin prej tyre!

Shembull	Link
Instrumente maqedonase	
Instrumente shqiptare	
Instrumente turke	
Instrumente rome	
Instrumente boshnjake	
Instrumente serbe	
Instrumente vllahe	





## Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë muzikore popullore

Muzika popullore është një pasuri e çdo populli. Ajo përcjell jetën, ndjenjat, zakonet dhe vlerat nga e kaluara. Por, që të mos harrohet, është e nevojshme të ruhet dhe të mbahet gjallë.

Trashëgimia muzikore është një grumbull këngësh popullore, vallesh, instrumentesh dhe interpretimesh që janë transmetuar nga brezi në brez. Ajo është pjesë e traditës sonë – ajo që e trashëgojmë nga të parët tanë.

Muzikën popullore duhet ta ruajmë për këto arsye:

- që të mos zhduket diçka që është pjesë e identitetit tonë;
- që edhe brezat e ardhshëm të mund ta dëgjojnë dhe studiojnë;
- sepse është unike dhe nuk haset askund tjetër në botë.

Tradita muzikore popullore mbrohet dhe mbahet gjallë në disa mënyra, si:

**Konservimi** – ruajtja e inçizimeve origjinale, shënimeve, instrumenteve dhe partiturave në muze, arkiva dhe biblioteka.

**Rekonstruktimi** – rikrijimi i këngëve, instrumenteve apo valleve të humbura apo të paplota, bazuar në hulumtime dhe dëshmi.

**Incizimi dhe arkivimi (arkiva zanore)** – inçizimi i këngëve popullore dhe ruajtja e tyre në formë digjitale (skedarë audio dhe video).

**Ngjarje dhe edukim** – përmes organizimit të festivaleve, aktiviteteve shkollore, grupeve folklorike dhe përfshirjes së muzikës popullore në mësim.

### Mëso më shumë!

- A e dini se ka këngë popullore që janë më të vjetra se 300 vjet, por ende këndohen edhe sot pothuajse në të njëjtën mënyrë si dikur? Në disa fshatra, të moshuarit janë “arkiva të gjalla” të trashëgimisë muzikore – ata mbajnë mend tekstet, meloditë dhe mënyrën e këndimit pa përdorur nota ose regjistrime!

- Është interesante që disa nga këto këngë janë ruajtur vetëm përmes inçizimeve në terren, ku studiuesit kanë udhëtuar me mikrofon dhe regjistruer dhe kanë regjistruar gjyshërit në oborret ose shtëpitë e tyre. Pikërisht këto regjistrime ruhen sot në arkiva zanore – si një pasuri e vërtetë muzikore për të ardhmen.

- Në vitin 1950 në Maqedoni u themelua Instituti për Folklor “Marko Cepenkov“, i cili është thesari i gjithë trashëgimisë kulturore-folklorike të popujve në Maqedoni.


## Aktivitete:

### 1. Pyetje për reflektim dhe diskutim:

- Çfarë do të ndodhte nëse askush nuk do ta ruante muzikën popullore?
- A din personalisht ndonjë këngë popullore? Nga kush e mësove?
- Cila mënyrë ruajtjeje të duket më interesante? Pse? (p.sh. inçizimi, rikonstruktimi, albumi digjital...)
- Çfarë mund të bësh ti për të ndihmuar që sot muzika popullore të mos harrohet?

### 2. Zbatimi i TIK për ruajtjen e traditës muzikore popullore.

- Zgjidh një nga detyrat e dhëna dhe ruaj një pjesë të traditës muzikore popullore:
- Regjistro një video apo audio inçizim të një personi të moshuar që këndon një këngë popullore!
- Krijë një prezantim apo poster për ndonjë instrument apo valle!
- Bëje një album digjital me fotografi, tekste dhe linqe!
- Merr pjesë në projekte online për folklorin dhe traditën!





## FJALOR

### A

Aria – melodi vokale me karakter ekspresiv.

Arza – goditje e patheksuar e taktit.

### Ç

Çelësi (i violinës, i basit) – simbol që tregon se cilat nota janë shkruar në vijat e pentagramit.

### D

Diafragma – muskul që përdoret në frymëmarrje, i rëndësishëm për kontrollin e ajrit gjatë këndimit.

Dijatonika – sistem i tingujve të përbërë nga tone dhe gjysmëtone që e ndërtojnë sistemin durmol.

Diksion – shqiptim i qartë dhe i kuptueshëm i fjalëve.

Dinamika – fuqia e toneve muzikore.

Dirigjent – personi që udhëheq korin ose orkestrën.

Dramatizim – interpretim me lëvizje, fjalë dhe shprehje emocionesh.

### E

Eho – në muzikë, efekt ku përsëritet pjesë e tekstit ose melodisë si jehonë.

Estetika – shkenca për të bukurën.

Etika – shkenca për moralin.

Etos – fuqia e muzikës për të shprehur karakter, disponim ose vlerë morale dhe të ndikojë mbi ndjenjat e njeriut.

### F

Fidela – instrument harkor mesjetar, pararendës i violinës.

Forma muzikore – struktura dhe organizimi i një vepre muzikore.

Fuga – vepër me shumë zëra me strukturë të ndërlikuar, bazuar në një temë.

### G

Grada – pozicioni i një note në shkallë (I, II, III...).

### GJ

Gjeneralbasi – linjë muzikore që shërben si bazë për harmoninë në muzikën e barokut.

Gjysmëton – distanca më e vogël midis dy toneve.

### H

Harmonia – pjesë e shkencës muzikore që i studion akordet.

Harmonia e sferave – koncept filozofik sipas të cilit planetët krijojnë „muzikë hyjnore”.

Heterofonia – teksturë muzikore me disa interpretues që luajnë të njëjtën melodi në të njëjtën kohë, por secili me variante dhe zbukurime të vogla.

Homofonia - teksturë muzikore ku një zë e udhëheq melodinë, kurse tjerët e përcjellin në mënyrë harmonike.

## I

Imitim – përsëritje e motivit muzikor në zë tjetër.

Instrumentarium - term që përdoret në muzikë për të treguar përbërjen e instrumenteve muzikore që përdoren në një vepër, ansambël ose orkestër.

Instrumente tradicionale – instrumente që përdoren për një kohë të gjatë dhe janë pjesë e kulturës popullore.

Interpretim instrumental – performancë vetëm me instrumente, pa këndim.

Interpretim vokal – interpretim muzikor me këndim, duke përdorur zërin njerëzor.

Interpretim vokalo-instrumental – kombinim i këndimit me instrumente.

Intervali – distanca midis dy toneve.

Interval harmonik – kur dy tone luhen njëkohësisht.

Interval melodik – kur dy tone luajnë njëri pas tjetrit.

Intonacion – saktësia në lartësinë e tingujve gjatë interpretimit.

## K

Kanconeta – këngë italiane me karakter lirik.

Katarza – emocione të krijuara nga përjetimi artistik.

Këngë artistike – këngë e shkruar nga kompozitor me tekst poetik dhe shoqërim instrumental.

Kënga popullore – këngë e vjetër me autor të panjohur, e transmetuar gojarisht.

Klaviçembalo – instrument me taste me tela, paraardhës i pianos.

Koncerto grosso – kompozim ku ndërrohen një grup i vogël solistësh dhe orkestra e plotë.

Konsorta – grupe të përbëra nga instrumente të ngjashme ose të njëjta.

Koral – këngë e thjeshtë religjioze, zakonisht për kor.

Korali gregorian – melodi kishtare njëzërore pa shoqërim instrumental, me tekst në latinisht.

Koreografi – lëvizje skenike ose vallëzim që shpreh muzikën.

Kori – grup këngëtarësh që këndojnë së bashku, më shpesh me dirigjent.

Kostumografi – veshjet e interpretuesve.

Kromatika – sistemi i lëvizjes së gjysmëtoneve në drejtim ngritës ose zbritës.

## L

Lartësi tonale – sa është i lartë ose i thellë një ton.

Libreto – teksti i operës.

Liturgji – rit fetar i shoqëruar me muzikë.

Lojëra popullore në grup – lojëra që luajnë disa njerëz së bashku, më shpesh vallëzime.

## M

Makami – shkallë muzikore orientale.

Melodia – mendim muzikor i krijuar nga një varg tingujsh.

Metri – ndryshim i vazhdueshëm midis pjesëve të theksuara dhe të patheksuara të taktit.

Minesinger – muzikant dhe poet udhëtar nga mesjeta.

Mjetet shprehëse – mënyra për të përcjellë ndjenja dhe ide në muzikë (si ritmi, melodia etj.).

Muzika laike – muzikë që nuk lidhet me religjionin.

Muzikë programatike – vepër që pasqyron një titull të caktuar.

Muzikë religjioze – muzikë për qëllime dhe rituale fetare.

## **N**

Narratori – person që lexon ose rrëfen pjesë të tregimit.

Neume – shenja të vjetra muzikore para shënimit modern të notave.

Notacioni alfabetik – emërtimi i toneve me shkronja latine: A, B, C, D, E, F, G.

Notacioni – sistem për shënimin e muzikës me nota.

## **O**

Organum – forma më e hershme e muzikës shumëzërëshe, ku zërat lëvizin paralelisht.

Orkestracioni – mënyra e përcaktimit të muzikës midis instrumenteve në orkestër.

Ornament – zbukurim.

## **P**

Pankrok, hardrok, rok psikodelik – stile të ndryshme brenda muzikës rok.

Partitura – shënim i shtypur ose dorëshkrim i një kompozimi muzikor.

Pasioni – kompozim vokalo-instrumental me karakter religjioz.

Pastorala – formë muzikore me karakter idilik, përshkruan ambient të qetë fshati.

Polifonia – muzikë shumëzërëshe, ku zëra të ndryshëm interpretohen njëkohësisht dhe janë të barabartë në rëndësi.

Preludium – vepër muzikore hyrëse e shkurtër.

Psalm – këngë religjioze me tekst nga Libri i Shenjtë.

Pushim – heshtje në muzikë.

## **R**

Reçitativ – mënyrë vokale e interpretimit që ngjan me të folur dhe ka karakter rrëfyës.

Ritmi – radhitje e tingujve me gjatësi të ndryshme.

Ritual – ceremoni e veçantë, shpesh fetare, që përsëritet sipas rregullave të caktuara.

Rit – veprime ose ceremoni të veçanta tradicionale.

## **S**

Sinkretizmi – bashkim i arteve të ndryshme në një (muzikë, vallëzim, dramë etj.).

Sistemi tonal – radhitja e të gjithë toneve në muzikë, të renditura sipas lartësisë.

Skenografi – pamja dhe rregullimi i skenës në teatër ose operë.

Solmizimi – sistem emrash muzikorë (do, re, mi...).

Solo vokal – këngëtar që këndon vetëm, pa zëra të tjerë.

Suita – kompozim ciklik i përbërë nga më shumë pjesë (pjesët zakonisht janë valle të stilizuara).

## **SH**

Shansona – këngë franceze e dashurisë.

Shenja të shartimit – shenjë që ndryshon lartësinë e notës (#, ♭, ♮).

Shkalla pentatonike – shkallë muzikore me pesë tone.

Shprehje vizuale – arti pamor në skenë: maska, rekvizita, simbole.

## **T**

Takt i parregullt – takt me pjesë të parregullta (p.sh. 5/8, 7/8).

Takt i përbërë – takt me dy ose më shumë thekse (p.sh. 4/4, 6/8).

Takt i thjeshtë – takt me një theks (p.sh. 2/4, 3/4).

Takt – pjesë e tekstit notal me numër të saktë goditjesh.

Tekstura - karakteristika e përgjithshme e tingëllimës së një kompozimi muzikor.

Tempo – shpejtësia e interpretimit të muzikës.

Tetrakordi – pjesë e shkallës që përbëhet nga katër gradë.

Teza – goditje e theksuar në takt.

Tonalitet – sistemi i toneve në muzikë (p.sh. dur ose mol).

Tone enharmonike – tone që ndryshe shënohen dhe njëjtë tingëllojnë.

Ton i plotë – i përbërë nga dy gjysmëtone.

Ton – tingull me fuqi, lartësi, gjatësi dhe ngjyrë të caktuar.

Trubadur – muzikant dhe poet shëtitës nga mesjeta.

Truver – muzikant dhe poet shëtitës nga mesjeta.

## **V**

Vija e taktit – vijë vertikale që ndan taktet.

Vlera e notës – koha që zgjat një notë.

## **Z**

Zërat në kor – soprano, alto, tenor, bas – ndarje sipas gjinisë dhe lartësisë së zërit.

## **ZH**

Zhanri – lloji ose stili i muzikës (si klasik, pop, xhaz, etj.).

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. Ѓорѓиев, Ѓ. М. (2020). *Најсѿар сѿил на македонскоѿо народно ѿеење*. Скопје: Арс Ламина.
2. Линин, А. (1986). *Народниѿе музички инсѿрументѿи во Македонија*. Скопје: Македонска книга.
3. Марковиќ, С. (1997). *Исѿорија музике за средње музичке школе*. Београд: Завод за уѿбенике и наставна средства.
4. Пеев, И. (1964). *Очерци ѿо меѿодика на обучението ѿо солфеж*. Софиа: Държавно издателство Наука и изкуство.
5. Светозаревиќ, Б. П. (2017). *Кулѿурно ѿулсирање низ времето*. Тетово: Иљо Антески Смок.
6. Тајчевиќ, М. (2000). *Основна ѿеорија на музикаѿта*. Скопје: Просветно дело.
7. Тајчевиќ, М. *Умеѿносѿиѿте и нивниѿе карактерисѿиќи*. Скрипта.
8. Филиповски, Ј. (1972). *Македонски народни ора*. Скопје: Македонска книга.
9. Abrashev, B., & Gadjev, V. (2012). *The world atlas of musical instruments*. Potsdam: H. F. Ullmann Publishing.
10. Andreis, J. (1967). *Vječni Orfej*. Zagreb: Školska knjiga.
11. Andreis, J. (1989). *Povijest glazbe* (Knjiga 1). Zagreb: SNL.
12. Andreis, J. (1989). *Povijest glazbe* (Knjiga 2). Zagreb: SNL.
13. Berisha, Ё. (1975). *Historia e muzikës I*. Prishtinë: (Dispensë).
14. Carl, S. E. (1938). *Psychology of music*. New York: Dover Publications.
15. Davies, B. (2023, August 7). *Michael Jackson’s influence: A retrospective on his impact on music and culture*. NWACrisisCenter. <https://nwacrisiscenter.org/michael-jacksons-influence-a-retrospective-on-his-impact-on-music-and-culture/>
16. Džorž, Š. B. (1991). *O muzici*. Beograd: Nolit.
17. El-Kilany, E. M. Y., Zoair, N., & Eshak, E. (n.d.). *Sound of music in Egypt: The musicians of ancient, Greco-Roman and the Byzantine Egypt – A comparative study*. Egyptian Journal of Tourism and Hospitality. (Viti nuk është i disponueshëm)
18. Ewen, D. (1973). *Enciklopedija glasbenih umetnin* (Prva knjiga). Ljubljana: Državna založba.
19. Ewen, D. (1973). *Enciklopedija glasbenih umetnin* (Druga knjiga). Ljubljana: Državna založba.
20. Ferreri, L., Mas-Herrero, E., Zatorre, R. J., Ripollés, P., Gomez-Andres, A., Alicart, H., ... Rodriguez-Fornells, A. (2019). Dopamine modulates the reward experiences elicited by music. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America*, 116(9), 3793–3798. <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC6397525/>
21. Filimon, R. C. (2023, July). *Syncretism and synaesthesia in music – unification of arts and perceptions*. *Artes Journal of Musicology*, 27(27–28), 167–184. [https://www.researchgate.net/publication/372539260\\_Syncretism\\_and\\_synaesthesia\\_in\\_music\\_-\\_unification\\_of\\_arts\\_and\\_perceptions](https://www.researchgate.net/publication/372539260_Syncretism_and_synaesthesia_in_music_-_unification_of_arts_and_perceptions)
22. Franceschini, G. (2024, December 24). *‘O SOLE MIO: A musical legacy of light and love*. Italo-Americano. <https://italoamericano.org/o-sole-mio/>
23. Hanslik, E. (1977). *O muzički ljepom*. Beograd: Beogradski izdavačko–grafički zavod.
24. Heveler, K. (1988). *Muzički leksikon*. Novi Sad: Budućnost.
25. Ilić, D. (2002). *Sredstva izražavanja u muzici*. Niš: Permanego.
26. Ksenija, M. R. (1996). *Psihologija muzike*. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva.
27. Kuk, D. (1982). *Jezik muzike*. Beograd: Nolit.

- 28.Lara, K. (1999). *Ndërtimi i formave muzikore*. Tiranë: Drier.
- 29.Michael, M. (1971). *Larousse encyclopedia of music*. London: Hamlyn.
- 30.Muçollari, G. (2023). *Bishat e rock'n'rollit*. Tiranë: Albas.
- 31.Musical (musical comedy, musical theatre). (2025, August 5). In *Encyclopedia Britannica*. <https://www.britannica.com/art/musical>
- 32.Owen, J. (2009, June 24). *Bone flute is oldest instrument, study says*. National Geographic. <https://www.nationalgeographic.com/culture/article/bone-flute-is-oldest-instrument--study-says>
- 33.Pejović, P. (1987). *Историја музике за музичке школе. Први гео*. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva.
- 34.Pejović, R. (1982). *Barokni koncert*. Beograd: Nolit.
- 35.Polena, I., & Tole, V. S. (2015). *Fjalor i muzikës klasike dhe popullore*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- 36.Rojko, P. (1982). *Psihološke osnove intonacije i ritma*. Zagreb: Muzikološki zavod Muzičke akademije.
- 37.Rojko, P. (2014). *Metodika e mësimet të muzikës* (B. Ramadani, Përkth.). Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.
- 38.Russell, D. A. (2002). *Musical instruments of antiquity as illustrated in The Adventures of Asterix the Gaul*. Pennsylvania State University. <https://www.acs.psu.edu/drussell/Asterix/02-RomanBrass.html>
- 39.Stringa, H. (2000). *Historia e muzikës botërore* (Pjesa e parë). Tiranë: Shtëpia botuese e librit universitar.
- 40.Stringa, H. (2000). *Historia e muzikës botërore* (Pjesa e dytë). Tiranë: Shtëpia botuese e librit universitar.
- 41.Vasilević, Z. M. (2000). *Metodika muzičke pismenosti*. Beograd.
- 42.Women in Ancient Music. (n.d.). *Encyclopedia.com – Humanities, Culture & Magazines*.

**Lidhje dhe burime të fotografive të shfrytëzuara:**









# ARTI MUZIKOR

për vitin I  
të gjimnazeve



ISBN: 978-608-4855-75-0



9 786084 855750